



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel: 0694057089

E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al

Nr. Prot. _____

424/
14

Tiranë, më 31/12/2019

Miratohet

Bujar Leskaj

KRYETAR



Raport Auditimi Performance "Efektiviteti i Çerdheve dhe Kopshteve"



Rinald MUÇA

Drejtor i Departamentit

Shënim: Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion jo publik dhe qëllimi i tij është gjenerimi i përgjigjeve zyrtare dhe administrative gjatë fazës së terrenit të auditimit nga ana e subjekteve të përfshira në auditim.



Departamenti i Performancës në KLSH

@Performanca

PËRMBAJTJA

1. Rëndësia e Auditimit	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës	5
1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë	6
1.4 Subjekti nën auditim.....	7
2. Qasja dhe detajet e auditimit	14
2.1 Objektivi dhe problemi.....	14
2.2 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit.....	14
2.3 Përkufizimet dhe terminologjia	15
2.4 Kriteret.....	16
2.5 Piramida e pyetjeve audituese	18
2.6 Rezultatet e parashikuara.....	19
3. Shtjellimi i pyetjeve dhe nën pyetjeve të auditimit	20
3.1 A është i plotë dhe bashkëkohor kuadri rregullator i cili orienton funksionimin e çerdheve dhe kopshteve?	20
3.2 A janë përmbushur me sukses dhe në afatë objektivat e vendosura për përmirësimin e shërbimit në çerdhe dhe kopshte?	29
3.3 Trajtimi i observacioneve	43
3.4 Përmbledhje	47
4. Aneksë	49
5. Grupi i punës dhe përgjegjësitë hierarkike	54

✂Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të (International Standards of Supreme Audit Institutions)
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
BT	Bashkia Tiranë
BV	Bashkia Vlorë
QEZHEF	Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
DPN3	Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, BT
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KKDMF	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
SZHAPU	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
PVF	Plani i Veprimtimit për Fëmijë
UP	Urdhri i Psikologut
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
OSHVT	Operatori Shëndetësor Vendor Tiranë
QE	Qendra Ekonomike

1. Rëndësia e Auditimit

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Gjatë viteve të fundit, KLSH i ka kushtuar gjithmonë e më shumë rëndësi auditimeve të performancës dhe shtimit të numrit të tyre. Misioni i KLSH-së si një institucion i pavarur kushtetues, është t'i shërbejë qytetarit shqiptar, duke qenë "agjent" i Kuvendit dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.¹

Tema e përzgjedhur ka për qëllim të paraqesë një studim mbi efektivitetin e veprimeve të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për garantimin e një shërbimi sa më optimal në kopshte dhe çerdhe. Kjo temë është përzgjedhur duke marrë parasysh impaktin madhor që ka në shoqërinë shqiptare zhvillimi dhe mirë rritja e brezave të ardhshëm dhe rëndësinë e këtyre institucioneve në edukimin, aftësimin dhe përgatitjen e tyre. Ndërhyrja cilësore në fëmijërinë e hershme ka një rendiment të lartë në arsimin bazë dhe më tej për të gjithë personat që përfitojnë nga kjo ndërhyrje. Si rrjedhim, është e rëndësishme të nxitet zhvillimi i një shërbimi parashkollor efektiv. Institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, duhet të veprojnë në përputhje me standardet përkatëse në fushën e sigurisë, shëndetit, numrit dhe aftësive të personelit në dispozicion si dhe të mbikëqyrjes së duhur të tyre. Rëndësia e këtij auditimi qëndron në pasqyrimin e gjendjes aktuale së shërbimit në çerdhe dhe kopshte, si dhe në kontribuimin në përmirësimin e këtij shërbimi nëpërmjet gjenerimit të rekomandimeve përfundimtare.

1.1 Konteksti i problemit social

*"Nuk mund të ketë zbulim më të thellë të shpirtit të një shoqërie
sesa mënyra me të cilën ajo trajton fëmijët e saj"*

Vitet e para të jetës së fëmijës janë më të rëndësishmet, pasi në këtë fazë hidhen themelet e para të sjelljeve dhe zakoneve të tyre. Shumë fëmijë në Shqipëri nuk e arrijnë potencialin e tyre të plotë sepse rriten në mjedise të kufizuara. Në mungesë të programeve të prindërimit, prindërit nuk kanë informacionin e duhur për rëndësinë e mësimin dhe zhvillimit të hershëm². Nën atë beqare mund të duhet të përballen me barrën e shtuar të kujdesit për fëmijët, ndërkohë që ndodhen edhe në rolin e kryefamiljareve, me qasje në burime të kufizuara financiare për tarifat parashkollore.

Përmirësimet graduale në aksesin e fëmijëve shqiptarë në arsimin parashkollor (3-5 vjet) pasqyrohen në Normat Aktuale të Regjistrimit Neto (NER – Net Enrollment Record) – 81% për fëmijët e moshës pesë vjeç dhe shumë më pak për fëmijët e moshës 4-5 vjeç. Sidoqoftë, sipas Studimit të Matjes së Standardeve të Jetesës për vitin 2012, pabarazitë në qasje sipas nivelit të të ardhurave vazhdojnë të ekzistojnë, 48% e fëmijëve nga familjet me të ardhura të larta kanë qasje në arsimin parashkollor përkundrejt vetëm 23% e fëmijëve në familjet me të ardhura të ulëta. Fëmijët romë përfitojnë shumë më pak nga arsimi i hershëm, megjithëse numri i romëve në kopshtet e Shqipërisë pothuajse është dyfishuar që nga viti 2011.³ Çerdhet dhe kopshtet zënë një vend të rëndësishëm në formimin

¹ Vendim i Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017 "Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH- së për Periudhën 2018 – 2022".

² <https://www.unicef.org/albania/early-childhood-development-and-learning>

³ <https://www.unicef.org/albania/early-childhood-development-and-learning>

harmonik të personalitetit të fëmijëve, nëpërmjet edukimit dhe formimit të tyre si individë të lirë, të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës në jetën shoqërore. Prindërit presin që institucionet e shërbimit parashkollor të ofrojnë mbi të gjitha një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për fëmijët e tyre. Pra, çerdhet dhe kopshtet përveç se të edukojnë fëmijën, duhet të garantojnë që ata të jenë të sigurt dhe të mbrojtur. Të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të fëmijëve duhet të mbrohen me përparësi nga çdo individ, familje dhe institucion, sepse kemi të bëjmë jo vetëm me qenie njerëzore përgjithësisht të pambrojtura, por edhe se niveli i sotëm i zhvillimit të tyre fizik e mendor, do të përcaktojë të nesërmen, të ardhmen e vendit tonë. Krahasuar me programet e tjera arsimore, kthimi i investimeve në arsimin e hershëm të fëmijëve është më i larti, veçanërisht për fëmijët që vijnë nga kushte jetese jo të favorshme⁴. Investimet arsimore më vonë në jetë, dihet se sjellin më pak kthime, dhe në mënyrë disproporcionale priren të përfitojnë nga fëmijët me prejardhje më të lartë socio-ekonomike. Ndër vite, në vendin tonë ka rezultuar problematike mungesa e kapaciteteve, kushteve të mjediseve të jashtme dhe të brendshme, cilësia e ushqimit, apo mangësitë në mjetet didaktike. Me gjithë përpjekjet e bëra, situata mbetet ende shqetësuese, kryesisht sa i takon tejkalimit të kapaciteteve dhe bazës materiale, e cila është e varfër dhe larg standardeve të përcaktuara⁵. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj fëmijëve në çerdhe e kopshte është domosdoshmëri, e cila mund të arrihet maksimalisht nëpërmjet shtimit dhe menaxhimit më të mirë të fondeve nga pushteti vendor e qendror, të cilat kanë si qëllim transformimin e infrastrukturës; rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve të reja; rritjen e cilësisë së ushqimit, trajtimin e fëmijëve nga ekipi edukator, mjekësor dhe punonjës social, çka do të sillte një impakt pozitiv në investimin e kryer për të ardhmen e brezit që rritet në shërbim të vendit. Ndërveprimi social përbën rrënjët e zhvillimit të shëndetshëm dhe një ndër kushtet më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të tyre, pasi përvoja e parë e jetës kolektive për fëmijët është hyrja në shërbimin parashkollor. Duke i kushtuar vëmendjen e duhur mirërritjes dhe zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve, theksi duhet vënë te një shërbim parashkollor efektiv që promovon mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të fëmijës. Kujdesi për fëmijërinë e hershme është faktori thelbësor që siguron shëndetin fizik e mendor, si dhe edukimin e zhvillimin e përgjithshëm të tyre.

1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës

Sipas përkufizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) auditimi i performancës është një “shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin”. Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga Ekzekutivi dhe mund të kryhet në të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditimet standarde financiare apo të ligjshmërisë pasi karakterizohet nga fleksibiliteti në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve. Auditimi i performancës është një metodë moderne nëpërmjet të cilës taksapaguesit, financierët, vendimmarrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi ushtrojnë kontroll mbi mënyrën e kryerjes së punës dhe arritjen e objektivave nga ana e enteve shtetërore. Ky lloj auditimi nuk ka si synim të kritikojë entet e mësipërme, por të arrijë

⁴<https://www.unicef.org/albania/early-childhood-development-and-learning>

⁵Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar

korrektimet e duhura, përmirësimin e 3E-ve dhe rritjen e mirëqenies sociale përmes aktiviteteve publike.⁶

Auditimi i Performancës nuk është më një praktikë e re në eksperiencën institucionale. I konceptuar në strategjinë e kaluar si një nga dy shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, sfidë madhore në rritjen e rolit auditues suprem në Shqipëri dhe e ardhmja e natyrshme institucionale, në linjë kjo me eksperiencat botërore, performanca është rritur shëndetshëm gjatë 5-vjeçarit të kaluar, duke e bazuar punën e saj në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin e ri 154/2014.

Në strategjinë 2018-2022, puna audituese në departamentin e performancës, krahas çështjeve mikro-ekonomike do të fokusohet edhe në ato makro-ekonomike.

Auditimi i Performancës në KLSH, në 5 vjeçarin e ardhshëm synon të rritet duke u bërë promotor i zhvillimit institucional dhe duke u konsoliduar në një auditim analitik, këshillues, bashkëpunues e vlerështues. Hierarkia drejtuese ka vendosur objektiva SMART të Departamentit të cilat synojnë që numri i auditimeve të performancës të shkojë në 30-35% të punës audituese institucionale.

1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë

Nga KLSH janë kryer në vitin 2014 dhe 2015, dy auditime performance mbi shërbimin parashkollor.

1. “Shërbimi Parashkollor”: Ky auditim është kryer bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 553/5, datë 27.03.2014, në subjektet Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, si dhe Drejtorinë Arsimore Rajonale, Tiranë. Ky auditim konkludoi: “Kopshtet dhe çerdhet, përveç qëndrimit të fëmijëve, përkujdesjes ndaj tyre dhe edukimit, ofrojnë edhe shërbimin ushqimor dhe atë shëndetësor e psiko-social. Godinat e trashëguara vite më parë të kopshteve dhe çerdheve kanë qenë të pakta në numër, pa sistem ngrohjeje qendrore dhe mjaft të amortizuara. Edhe pse të pamjaftueshme për të përballuar kërkesat e shumta, ndërtimet e reja apo rikonstruksionet e kryera vitet e fundit nga Bashkia dhe vënia në shfrytëzim e tyre nga QEZHEF, kanë ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të akomodimit të fëmijëve. Veprimtaria e shërbimit parashkollor bazohet në standarde sasiore dhe cilësore të përcaktuara qartë, të cilat janë të përafërta me ato të aplikuara në vendet e OECD. Këto standarde janë hartuar nga Bashkia dhe Ministria e Arsimit me ndihmën e UNICEF dhe shtrihen që nga fëmijëria e hershme e deri tek arsimi parashkollor. Por përtej arritjeve të shumta, sot shërbimi parashkollor përballlet me sfida dhe me problematika të larmishme, duke filluar që nga aksesimi i kufizuar në kopshte dhe çerdhe e deri tek cilësia e diskutueshme e shërbimeve që ato ofrojnë”.⁷
2. “Performanca Ekonomiko Financiare e Strukturave Përgjegjëse Për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve Parashkollorë”: Ky auditim është kryer bazuar në programin e auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 371/3, datë 24.07.2015. Auditimi u krye në QEZHEF Tiranë, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Kukës, Bashkinë Elbasan, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Vlorë. Ky auditim konkludoi: “Ofrimi i një shërbimi sa më të mirë, nisur nga shqetësimi në lidhje me hartimin e politikave dhe strategjive mbi trajtimin e fëmijëve në çerdhe

⁶Ekonomicitet, Eficiencë, Efektivitet; ndërkohë që nga zhvillimet e fundit promovohet aplikimi i 6E-ve, së bashku me Energy, Environment, Ethics (Energji, Mjedis, Etikë).

⁷http://www.klsh.org.al/web/njofitimi_per_web_sherbimi_parashkollor_1266.pdf

dhe kopshte; shtimi i kapaciteteve dhe hapjes së ambienteve të reja; pengesat në menaxhim, si pasojë e ndërvarësive institucionale; mungesa të fondeve dhe çelja e tyre me vonesë; mënyra e funksionimit të këtij shërbimit; pagat e ulëta të ekipit edukator dhe ndihmës që merret me trajtimin e fëmijëve; trajtimi i fëmijëve në mënyrë të barabartë; lufta kundër korrupsionit. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj fëmijëve në çerdhe e kopshte është domosdoshmëri e cila mund të arrihet maksimalisht ndërmjet shtimit dhe menaxhimit më të mirë të fondeve nga pushteti vendor e qendror të cilat kanë si qëllim; transformimin e infrastrukturës; rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve të reja; rritjen e cilësisë së ushqimit; trajtimin e fëmijëve nga ekipi edukator dhe mjekësor; çka do të sillte një impakt pozitiv në investimin e kryer për të ardhmen e brezit që rritet në shërbim të vendit”.⁸


1.4 Subjekti nën auditim

Institucionet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, e cila është një njësi ekonomike administrative e mirërritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve në varësi të Bashkisë së Tiranës.⁹

Bashkia Tiranë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit (DPN 3), e cila ndër detyrat e saj parësore ka dhe mirëmbajtjen e kopshteve dhe çerdheve.

Bashkia Vlorë, nëpërmjet Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik bën administrimin e çerdheve, si dhe nëpërmjet Specialistes së Arsimit në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja, ndjek administrimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë, ku bëjnë pjesë dhe kopshtet.¹⁰ Auditimi mbi administrimin e çerdheve dhe kopshteve në Tiranë dhe Vlorë, do të realizohet nëpërmjet auditimit të tre subjekteve:



Burimi: Grupi i auditimit

1.4.1 Hyrje në subjektet në auditim

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e sistemit parashkollor të përzgjedhura në këtë auditim, janë: Bashkia Tiranë, Qendra Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve dhe Bashkia Vlorë.

⁸http://www.klsh.org.al/web/njoftim_per_web_per_raportin_e_auditimit_QEZHEF_2198_1_2132.pdf

⁹Rregullore e QEZHEF, bazuar në Urdhër Nr.7244, dt.04.03.2016 të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës “Për riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës”.

¹⁰Rregullorja e Bashkisë Vlorë, viti 2018.

Bashkia Tiranë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3, ka përgjegjësinë për mirë administrimin e çdo çështje që lidhet me realizimin e investimeve në kohë dhe me cilësi në objektet e infrastrukturës së ndërtesave urbane në qytetin e Tiranës (shkollat, kopshtet, çerdhet, qendrat sociale, bibliotekat etj.), duke siguruar përmirësimin e infrastrukturës të këtyre ndërtesave dhe kushteve të mësimdhënies, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative, nëpërmjet përdorimit eficient dhe efikas të burimeve financiare dhe njerëzore.¹¹ Sa i takon objektivave dhe prioriteteve strategjike të BT lidhur me çështjen nën auditim, rezulton se në dokumentin Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë, çerdhet dhe kopshtet përfshihen në 3 nga 4 objektivat strategjike të BT, si më poshtë:

- ✓ Objektivi Strategjik 1: Tirana Policentrike, rivitalizim urban që harmonizon infrastrukturën, shërbimet publike dhe nxit zhvillimin ekonomik, i cili në nën objektivat e tij specifike parashikon rikonstrukcionin e një çerdhe dhe 4 kopshteve;
- ✓ Objektivi Strategjik 2: Arsimi për të gjithë, i cili në nën objektivat e tij specifike parashikon ndërtimin e 8 çerdheve dhe 7 kopshteve të reja nëpërmjet Partneritetit Publik Privat, si dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese për 2 çerdhe dhe 11 kopshte;
- ✓ Objektivi Strategjik 4: Tirana për të gjithë, i cili në nën objektivat e tij specifike parashikon përzgjedhjen e një kategorie ndërtesash (shkolla, institucione publike, apo ndërtesa të një segmenti të caktuar, rrugë etj.) për shtimin e hapësirave të gjelbërta me 6 fasada. Megjithatë, ky objektivi nuk i adresohet specifikisht institucioneve parashkollore.

QEZHESH është një njësi ekonomike administrative e mirërritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve e krijuar në Prill të vitit 2004, me VKB Nr. 14, datë 10.03.2004, si rrjedhojë e bashkimit të Qendrës Ekonomike të Arsimit me Drejtorinë e Çerdheve.¹² Ka përgjegjësi të ofrojë për fëmijët e çerdheve dhe kopshteve, çdo ditë, kujdes edukativ, psiko-social, koordinim të kujdesit shëndetësor dhe shërbime ekonomike. Konkretisht, për çështjen nën auditim, *QEZHESH* ka si mision veprimin në emër të të drejtave dhe mirëqenies së të gjithë fëmijëve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre, duke siguruar shëndetin fizik e mendor dhe edukimin e zhvillimin e gjithanshëm të tyre. *QEZHESH* operon në bazë të rregullores së miratuar me Urdhrin Nr. 7244, dt. 04.03.2016, ku disa nga parimet kryesore të funksionimit të saj fokusohen në:

- ✓ Parimin e barazisë, ku të gjithë qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, arsimit, etnisë, gjendjes ekonomike e sociale, bindjeve politike e fetare etj.
- ✓ Parimi i ligjshmërisë, ku të gjithë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre për përmbushjen e funksioneve të *QEZHESH*, janë të detyruar të zbatojnë Kushtetutën dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Askujt nuk i lejohet shmangia nga detyrimet ligjore, moszbatimi i ligjit apo zbatimi i gabuar i tij, për shkak të padijenisë së ligjit.
- ✓ Parimi i mbrojtjes së interesit publik, ku administrata e *QEZHESH*, duhet të veprojë në përmbushje të detyrave të tyre, vetëm në interes të publikut.
- ✓ Parimi i transparencës, ku administrata e *QEZHESH*, duhet të jetë sa më transparente për publikun, në të gjitha vendimet apo veprimet që ndërmerret. *QEZHESH*, ushtron veprimtarinë e saj për rritjen e kapaciteteve infrastrukturore, rritjen e kapaciteteve ekonomike dhe logjistike, për të siguruar një shërbim sa më

¹¹ Rregullore e Bashkisë Tiranë me VKB nr. 25661, datë 02.07.2018 Për "Një ndryshim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës".

¹²<http://femijetetiranes.al/ep-content/uploads/2018/08/Rregullore-perfundimtare-e-QEZHESH.pdf>

cilësor, komform standardeve për çerdhet/kopshtet. QEZHEF, është e përqendruar në administrimin dhe menaxhimin e aktivitetit të saj në 34 çerdhe e 45 kopshte publike të zonës urbane dhe 54 grupe në zonën rurale të Bashkisë Tiranë.

Bashkia Vlorë është përgjegjëse për përcaktimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet të Administratës së Bashkisë Vlorë, në veprimtarinë e saj për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore.¹³ Bashkia Vlorë është e përqendruar në administrim dhe menaxhimin e aktivitetit të saj në 3 çerdhe e 16 kopshte. Objekt i auditimit në Bashkinë Vlorë do të jenë Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik, për administrimin e çerdheve, si dhe Specialisti i Arsimit në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja, për menaxhimin e kopshteve në Bashkinë Vlorë. Nga informacionet e vëna në dispozicion, rezulton se BV nuk ka strategji, prioritete, apo objektiva që lidhen specifikisht me çështjen nën auditim. Drejtoritë e sipërpërmendura angazhohen dhe shërbejnë si urë lidhëse mes BV dhe institucioneve parashkollore, të cilët identifikojnë problematikat dhe nevojat që lindin në këto institucione dhe i adresojnë ato për zbatim pranë Qendrës Ekonomike (Sektorit i Financës pranë BV), pa u mbështetur në objektiva konkrete dhe të matshme.

1.4.2. Politikat e institucionit/agjencisë

QEZHEF, është i përqendruar në administrimin dhe menaxhimin ekonomiko-financiar të aktivitetit të çerdheve e kopshteve në drejtim të planifikimit, detajimit dhe ndjekjes së treguesve ekonomikë-financiarë të buxhetit, planifikimit dhe ndjekjes së shpenzimeve, realizimit të vjeljes së të ardhurave nga pagesat e prindërve për kuotat e ushqimit të fëmijëve në çerdhe; organizon dhe ndjek mirërritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të moshës (0-3 vjeç) në çerdhe. Në mungesë të një dokumenti strategjik apo prioritetesh me objektiva të përcaktuar dhe afate kohore, për të përmbushur këto funksione, veprimtaria e QEZHEF mbështetet mbi objektiva vjetore të vendosura pas çdo analize vjetore të vitit paraardhës që lidhen me:

- rritjen e nivelit të cilësisë së shërbimit duke përmirësuar të gjithë elementët;
- aplikimin e një menuje me artikuj të larmishëm ushqimorë;
- sigurimin e një shërbimi psiko-social cilësor dhe efektiv;
- informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për mundësinë e hapjes së shërbimit alternativ të çerdhes, atë me bazë në komunitet;
- rekrutimin e një stafi profesional me kapacitetet e duhura për të ofruar shërbimin e kujdesit ndaj fëmijës.

Ky institucion administron plotësisht çerdhet, ndërkohë që për kopshtet, edukimi dhe zhvillimi i fëmijëve, programet mësimore, si dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, varet nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë. Në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve citohet se “në themel të saj qëndrojnë dokumente strategjike dhe plane veprimi kombëtare, të cilat përcaktojnë drejtimet kryesore të veprimit të Qeverisë në këto fusha dukë përfshirë edhe prioritete që kanë ndikim në jetën e fëmijëve”.¹⁴ Një nga këto dokumente është pikërisht Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014 – 2020, në të cilën kopshtet zënë një vend shumë të vogël, duke u përfshirë në objektivin strategjik B “Gjithëpërfshirja”, vetëm sa i takon aksesit të fëmijëve në këto institucione, por pa veprime dhe tregues konkretë për arritjen e tyre.

¹³Vendim Nr.11, datë 29.03.2012 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrimeve dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë”

¹⁴ Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020

Bashkia Tiranë, duke qenë përgjegjëse vetëm për pjesën infrastrukturore, ka përfshirë në dokumentin e saj strategjik për zhvillimin e qendrueshëm vetëm objektiva që lidhen me ndërtimin apo rikonstruksionin e ambienteve, siç është përmendur në rubrikën më lart.


Bashkia Vlorë nuk ka politika të mirëfillta për administrimin e çerdheve dhe kopshteve, duke qenë se e ka kufizuar menaxhimin e tyre tek: Drejtorja e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik, e cila ndër të tjera bën administrimin e çerdheve, si dhe Specialistja e Arsimit në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja, e cila ndjek administrimin e arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë, ku bëjnë pjesë dhe kopshtet. Gjithë veprimtaria dhe aktiviteti i tyre rregullohet nëpërmjet Rregullores së Bashkisë Vlorë, në të cilën çerdhet dhe kopshtet përmenden në mënyrë të përciptë. Për sa më lart, mbetet përgjegjësi e të gjitha Bashkive, neglizhenca në marrjen e iniciativës për hartimin e një dokumenti strategjik gjithëpërfshirës me prioritete të qarta për garantimin e një shërbimi sa më optimal në çerdhe dhe kopshte.

1.4.3 Pësia në buxhet

Bashkia Tiranë dhe QEZHEF


Për vitin 2017, me VKB nr. 84, datë 29.12.2016, Bashkia Tiranë ka planifikuar një fond total të ardhurash në vlerën 14,426,919,744 lekë dhe shpenzime totale po në këtë vlerë. Nga ky fond, me gjithë shtesat dhe pakësimet që kanë ndodhur gjatë periudhës, rezulton se vlera totale e buxhetit për QEZHEF është në shumën 1,418,367,191 lekë ose në masën 9.8% të buxhetit të Bashkisë. Nga kjo vlerë, 4,610,000 lekë ose vetëm 0.3% e buxhetit në dispozicion të QEZHEF, janë parashikuar për investime, të cilat sipas deklaratave financiare rezultojnë të pa realizuara për faktin se këto investime që lidhen me blerjen e pajisjeve kompjuterike janë paguar në vitin pas ardhës si pasojë e vendosjes së limitit të përdorimit të kesh-it për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Financave në vitin 2017 me shkresën nr.15973 dt 09.11.2017. Për vitin 2017, rezulton se fondet në dispozicion të QEZHEF janë realizuar në vlerën 1,292,929,286 lekë. Ndërkohë, për Ndërmarrjen e Punëtorëve të Qytetit nr. 3, e cila është përgjegjëse ndër të tjera për mirëmbajtjen dhe investime në objektet parashkollore, fondi total në dispozicion për vitin 2017 është planifikuar në vlerën 313,934,875 lekë dhe është realizuar në vlerën 233,923,203 lekë ose në masën 75%. Krahasuar me buxhetin e Bashkisë, fondet për këtë ndërmarrje përbëjnë vetëm 2%, ku përmendim faktin se nën përgjegjësinë e saj nuk është mirëmbajtja dhe investimet vetëm për objektet parashkollore. Nga fondi total i DPN3, është parashikuar për investime vlera prej 107,584,875 lekë dhe është realizuar në vlerën 69,347,000 lekë ose 64%. Të dhënat më lart paraqiten grafiksht si vijon:

BUXHETI 2017




Investimet QEZhEF

■ Parashikuar ■ Realizuar




Investimet DPN3

■ Parashikuar ■ Realizuar




Burimi: Grupi i auditimit

Për vitin 2018, me VKB nr. 132, datë 22.12.2017, Bashkia Tiranë ka planifikuar një fond total të ardhurash në vlerën 16,315,881,000 lekë dhe shpenzime totale po në këtë vlerë. Nga ky fond, me gjithë shtesat dhe pakësimet që kanë ndodhur gjatë periudhës, rezulton se vlera totale e buxhetit për QEZHEF është në shumën 1,581,190,761 lekë ose në masën 9.7% të buxhetit të Bashkisë. Nga kjo vlerë, 6,620,000 lekë ose vetëm 0.4% e buxhetit në dispozicion të QEZHEF, janë parashikuar për investime, të cilat janë realizuar në vlerën 6,418,560 lekë. Për vitin 2018, rezulton se fondet në dispozicion të QEZHEF janë realizuar në vlerën 1,492,839,799 lekë. Ndërkohë, për Ndërmarrjen e Punëtorëve të Qytetit nr. 3, fondi total në dispozicion për vitin 2018 është planifikuar në vlerën 504,018,712 lekë dhe është realizuar në vlerën 309,351,745 lekë ose në masën 61%. Krahasuar me buxhetin e Bashkisë, fondet për këtë ndërmarrje përbëjnë vetëm 3%. Nga fondi total i DPN3 është parashikuar për investime vlera prej 208,612,863 lekë dhe është realizuar në vlerën 95,297,549 lekë ose 46%. Të dhënat më lart paraqiten grafikisht si vijon:




Investime QZHEF

■ Parashikuar ■ Realizuar



Investime DPN3

■ Parashikuar ■ Realizuar



Burimi: Grupi i auditimit

Bashkia Vlorë 2017-2018¹⁵

Për vitin 2017, me VKB nr. 3, datë 31.01.2017, Bashkia Vlorë ka planifikuar një fond total të ardhurash në vlerën 2,590,837 lekë dhe shpenzime totale po në këtë vlerë. Për çështjen nën auditim, buxheti i Bashkisë Vlorë, ndahet në zërat arsimit dhe çerdhet, ku tek arsimit bëjnë pjesë edhe kopshtet. Nga ky fond, rezultojnë se vlera totale e buxhetit për zërat “Arsimi” dhe “Çerdhet” është parashikuar në shumën 269,211 lekë ose në masën 10% të buxhetit të Bashkisë. Ndërsa për zërin investime, nga vlera totale prej 842,363 lekë, për çështjen objekt auditimi janë parashikuar investime në vlerën 34,500 lekë, ose në masën 4%. Nga dokumenti “Analiza e Buxhetit 2017”, rezultojnë se nuk është realizuar asnjë investim për zërat kopshte ose çerdhe, por vetëm për arsimin 9 vjeçar e më lart.

Për vitin 2018, me VKB nr. 107, datë 28.12.2017, Bashkia Vlorë ka planifikuar një fond total të ardhurash në vlerën 2,004,432 lekë dhe shpenzime totale po në këtë vlerë. Për çështjen nën auditim, buxheti i Bashkisë Vlorë, ndahet në zërat arsimit dhe çerdhet, ku tek arsimit bëjnë pjesë edhe kopshtet. Nga ky fond, rezultojnë se vlera totale e buxhetit për zërat “Arsimi” dhe “Çerdhet” është parashikuar në shumën 358,041 lekë ose në masën 18% të buxhetit të Bashkisë. Ndërsa për zërin investime, nga vlera totale prej 267,463 lekë, për çështjen objekt auditimi janë parashikuar investime në vlerën 33,000 lekë, ose në masën 12%. Nga dokumenti “Analiza e Buxhetit 2018”, rezultojnë se nuk është realizuar asnjë investim për zërat kopshte ose çerdhe, por vetëm për arsimin 9 vjeçar dhe të mesëm.

1.4.4. Risqet e aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktiviteteve të subjektit nën auditim kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucioni has në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave e funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë auditim, analiza e riskut është mbështetur në identifikimin e risqeve sipas 6 elementëve të analizës PESTLE si më poshtë:

Politike	Ekonomike	Sociale	Teknologjike	Ligjore	Mjedisore (Enviroment)
Mungesa e politikave dhe strategjive specifike për	Vonesa në përgjigjet nga Bashkia për nevoja në ndërhyrje të kopshteve dhe	Lëvizje të shpeshta demografike dhe	Standarde tepër të vjetra në kohë dhe të	Kompleksiteti i aktorëve të përfshirë në menaxhimin e	Ambiente jo të mjaftueshme të gjelbra; Mundësia e

¹⁵ Shënim: Për të dhënat për buxhetin e Bashkisë Vlorë grupi I auditimit është mbështetur në Buxhetin e publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë, pasi në formë shkresore nuk u vu në dispozicion ky informacion.

çështjen nën auditim; mungesa e konceptimit konkret dhe sasi të disa prej objektivave të parashikuara	çerdheve; Buxhet i limituar në dispozicion të njësisve përgjegjëse për ; Vonesa në përfundimin e punimeve (investime, rikonstruksione)menaxhimin e kopshteve dhe çerdheve;	migrimi i brendshëm informal	pa përditësuara	kopshteve dhe çerdheve	përmbajtjes së asbestit në godinat e vjetra ekzistuese
---	--	------------------------------	-----------------	------------------------	--

Burimi: Grupi i auditimit

1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

Produktet e QEZHEF lidhen me zbatimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së administratës dhe punonjësve të saj, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. QEZHEF si institucion vendor, person juridik, publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës, është struktura përgjegjëse e cila vepron në emër të të drejtave dhe mirëqenies së të gjithë fëmijëve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre, duke siguruar shëndetin fizik e mendor dhe edukimin e zhvillimin e gjithanshëm të tyre. Në përmbushje të misionit të saj, QEZHEF ka si produkt shërbimin sa më optimal lidhur me:

- tenderimin dhe transportimin e ushqimeve në të gjitha institucionet parashkollore;
- sigurimin e bazës didaktike dhe gjithë materialeve të nevojshme gjatë qëndrimit të fëmijës në këto hapësira;
- ofrimin e shërbimit të mjekut dhe punonjësit social;
- garantimin e higjienës dhe sigurisë në këto ambiente;
- çdo shërbim tjetër që lidhet me trajtimin e fëmijëve gjatë qëndrimit të tyre në çerdhe dhe kopshte.

Në thelb të të gjitha këtyre veprimeve mbetet siguri që të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, aftësie dhe etnie të kenë qasje të barabartë në shërbimet e ofruara, të nxitet dhe promovohet një qasje cilësore edukative me fëmijët përmes rritjes së ndërgjegjësimit mbarëkombëtar mbi rëndësinë e madhe të investimit në arsimin parashkollor¹⁶.

Bashkia Tiranë:

- përgatit aktet ligjore dhe nënligjore;
- harton dhe ndjek politikat, strategjitë dhe planet e veprimit.

Për çështjen objekt auditimi, në zbatim të VKB nr.15, datë 10.03.2004 së Bashkisë Tiranë, është përgjegjëse Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit. Kjo drejtori:

- kryen mirëmbajtjen e shkollave, kopshteve, çerdheve, godinave publike, banesave, vendstrehimeve.
- Në funksion të përmbushjes së detyrave të saj, kjo njësi edhe në bashkëpunim me QEZHEF identifikon problematikat dhe nevojat për ndërhyrje, mirëmbajtje, rikonstruksione, apo ndërtime të reja të çerdheve dhe kopshteve që administron BT.

¹⁶https://www.unicef.org/albania/media/381/file/Standardet_e_zhvillimit_dhe_te_nxenit_te_femijeve_3-6_vjec.pdf

Bashkia Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit e Shëndetit Publik dhe Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja, së bashku me Qendrën Ekonomikë pranë Bashkisë, kryejnë të gjitha funksionet që në Tiranë kryhen nga Bashkia dhe QEZHEF. Konkretisht, produkt i këtij subjekti janë të gjitha shërbimet që lidhen me funksionimin ditor të kopshteve dhe çerdheve, siç janë:

- prokurimi dhe transportimi i ushqimeve në të gjitha institucionet parashkollore;
- sigurimi i bazës didaktike dhe gjithë materialeve të nevojshme gjatë qendrimit të fëmijës në këto hapësira;
- garantimi i higjienës dhe sigurisë;
- mirëmbajtja dhe rikonstruksioni i hapësirave të kopshteve dhe çerdheve.

1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit

Sa i përket bashkëpunimit të subjekteve në auditim për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm ka rezultuar si më poshtë:

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, i është përgjigjur me korrektësi të gjitha kërkesave dhe pyetësorëve të grupit të auditimit dhe ka vënë në dispozicion, brenda afateve dokumentacionin e plotë të kërkuar.

Bashkia Tiranë ka kthyer me vonesë përgjigjet e pyetësorëve të dërguar.

Bashkia Vlorë gjatë fazës së terrenit ka bashkëpunuar me korrektësi me grupin e auditimit.

2. Qasja dhe detajet e auditimit

2.1 Objektivi dhe problemi

Auditimi i performancës me temë “Performanca e Çerdheve dhe Kopshteve” synon të ofrojë një panoramë të qartë mbi situatën dhe aktualitetin, lidhur me efektivitetin e sistemit parashkollor në vendin tonë, nëpërmjet shqyrtimit dhe analizimit të masave të marra nga institucionet që kanë nën juridiksion menaxhimin e kësaj çështje. Vëmendja e këtij auditimi do të jetë në shqyrtimin e zbatimit të politikave dhe planeve të veprimit që aktorët e përfshirë kanë hartuar për realizimin me sukses të misionit të tyre për identifikimin e nevojave mbi shërbimin e ofruar në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve, në mënyrë që të ofrohet një informacion i plotë mbi performancën e strukturave përgjegjëse publike të përfshira. Në këtë mënyrë do të mund të konkludohet se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi.

2.2 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit

Institucionet parashkollore mund të konsiderohen baza e piramidës së përgatitjes dhe zhvillimit të fëmijëve si qytetarë të denjë të një vendi. Duke marrë parasysh kohën që fëmijët kalojnë në këto institucione dhe të gjitha shërbimet që marrin gjatë ditës, që nga ushqimi, higjiena, edukimi dhe aplikimi i programeve psiko-sociale për zhvillimin e tyre, këto institucione konsiderohen përgjegjësit kryesor në mirërritjen e fëmijëve dhe diktojnë rrugën e tyre drejt zhvillimit. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij shërbimi për brezat e ardhshëm dhe duke marrë shkas nga problematika e trajtuar në median e shkruar dhe elektronike lidhur me mbipopullimin e këtyre institucioneve apo menunë ushqimore, në përfundim të fazës studimore, u konkludua se fokusi i këtij auditimi do të jetë performanca e subjekteve nën auditim në ofrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme sa më bashkëkohore, garantimin e sigurisë së fëmijëve gjatë qendrimit të tyre në kopshte dhe çerdhe, si dhe kushtet higjieno-sanitare, apo cilësia e ushqimeve që shërbehen. Konkretisht, grupi i auditimit do të marrë në shqyrtim masat dhe veprimet e

ndërmarra nga Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë dhe për përmbushjen e objektivave të tyre për periudhën 2017-2018, veprime të cilat lidhen me:

- identifikimin dhe përmbushjen në kohë të nevojave për investime, mirëmbajtje, riparime, etj në ambientet fizike brenda dhe jashtë kopshteve, në përmbushje të standardeve të projektimit, hapësirave, lehtësive në këto ambiente, etj.;
- mirë menaxhimin e kapaciteteve aktuale;
- identifikimin e problematikave që lindin në përditshmëri lidhur me cilësinë e ushqimeve, furnizimin në kohë apo ruajtjen e tyre në kushte sa më të përshtatshme, si dhe kontrolli mbi zbatueshmërinë korrekte të menusë;
- garantimin e një shërbimi mjekësor dhe psiko-social cilësor dhe vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë apo bashkëpunimit me bordet prindërore;
- garantimin e sigurisë së fëmijës nëpërmjet pajisjes me elementët e nevojshëm në raste rreziku, apo faciliteteve që nuk çënojnë sigurinë e tyre.

Së fundmi, duke patur parasysh kompleksitetin e aktorëve të përfshirë në menaxhimin e kopshteve dhe çerdheve, auditimi do të fokusohet edhe në shqyrtimin e nivelit të koordinimit mes tyre dhe përditësimit të kuadrit rregullator që orienton menaxhimin e këtyre institucioneve. Në fokusin e auditimit, do të jenë Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë dhe objektivat e tyre përkatëse, sipas fushës së përgjegjesisë.

2.3 Përkufizimet dhe terminologjia

"Fëmijë në rrezik" është fëmija, të cilit i mohohen ose i çënohen të drejtat dhe mbrojtja e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

"Mbrojtje e fëmijës" është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikën e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjentiale dhe martesë e fëmijëve.

"Informacion përkatës" është informacioni i përshtatshëm për moshën dhe arsyetimin e fëmijës dhe që do të jepet për t'i mundësuar fëmijës të ushtrojë plotësisht të drejtat e tij apo të saj, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës.

"Mbajtësit e përgjegjësive prindërore" janë prindërit dhe persona të tjerë ose organe, të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë disa ose të gjitha përgjegjësitë prindërore.

"Autoritet shtetëror përgjegjës" është organi ose institucioni shtetëror, në nivel qendror a vendor, i cili, brenda fushës së veprimtarisë së tij, kryen dhe mbulon shërbime të specializuara e profesionale për fëmijët.

"Dhunë ndaj fëmijëve" është përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër fëmijës a grupit të fëmijëve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keq zhvillim ose privim.

"Dhuna psikologjike" përfshin veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.

"Dhunë fizike" është çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, përfshirë edhe ndëshkimin trupor të tij, të cilat nuk janë aksidentale.

"Multidisiplinar" është vlerësimi i koordinuar ligjor, social, psikologjik, shëndetësor, arsimor dhe kulturor i gjendjes së fëmijës.

"Ndërhyrje e paligjshme për ruajtjen e identitetit" është moslejimi i përdorimit të gjuhëve të pakicave kombëtare në sistemin arsimor e në media; persekutimi shtetëror apo shtypja e besimit fetar; mosnjohja e mundësisë për fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të cilët janë vendosur në institucione, familje kujdestare apo të birësuar, që të gëzojnë trashëgiminë e tyre etnike, kulturore, gjuhësore dhe fetare.

"Prind" është personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë.

"Neglizhenca e fëmijës" është mos dhënia dhe mos përmbushja e nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim.

"Organizatë jofitimprurëse" është organizata e krijuar në përputhje me legjislacionin për organizatat jofitimprurëse, që ka si objekt të veprimtarisë së saj, të përcaktuar në statut dhe/ose në aktin e themelimit, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës.

"Kequshqyerja" është një term i përgjithshëm që mbulon çrregullimet shëndetësore që shkaktohen nga marrja e papërshtatshme e lëndëve ushqyese dhe e energjisë me ushqimet.

"Nënushqyerja" është një gjendje e shkaktuar nga mungesa e lëndëve ushqyese dhe energjisë që merren me ushqime.

"Mbiushqyerja" është një gjendje e shkaktuar nga ngrënia e tepërt e ushqimeve të pasura me energji së bashku me një aktivitet të pakët fizik.

2.4 Kriteret

2.4.1 Kriteret e politikës

- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020
- Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020;
- E Ardhmja e Sistemit të Integruar për Mbrojtjen e Fëmijës në Shqipëri;
- Plani i Veprimit për Fëmijë 2012 – 2015;
- Standardet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të Fëmijëve 3-6 vjeç.

2.4.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Artikuj nga media e shkruar dhe elektronike;
- Analiza të veprimtarisë së QEZHEF;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e QEZHEF;
- Rregullore e funksionimit dhe administrimit të çerdheve dhe kopshteve;
- Rregulloret për shërbimin shëndetësor në kopshte dhe çerdhe;
- Rregullore Higjieno – Sanitare e Ministrisë së Shëndetësisë nr. 3236, datë 26.10.1994;
- Standardet e projektimit të çerdheve;
- Standardet e projektimit të kopshteve;
- "Udhëzues mbi ushqyerjen e shëndetshme për fëmijët e shkollave" – Organizata Botërore e Shëndetësisë.

2.4.3 Kriteret teknike


- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr.18/2017, datë 23.02.2017 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës";
- Ligji nr.10 433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë nr. 05, datë 12.01.2016 “Për ndryshimet në menunë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”;
- Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për ndryshimet në menunë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”;
- Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 457, datë 13.06.2018 “Për ndryshimet në menunë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”;
- Konventa e të drejtave të Fëmijëve, Strasburg 25.1.1996. Ligji nr .10425, dt 2.06.2011 për ratifikimin e konventës;
- VKB nr. 14, datë 10.03.2004 për krijimin e QEZHEF;
- VKB, nr 59 datë 30.12.2015. për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”;
- VKB nr. 100, datë 22.12.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” BV
- VKN nr. 40 datë 29.03.2018 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.59, Datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Tiranës”, të ndryshuar;
- Udhëzuesi “Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i kopshtit”, IKAP 2011;
- Urdhri nr. 7244, datë. 04.03.2016 “Për riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës”;
- Vendim nr. 11, datë 29.03.2012 “Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrimeve dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë”;
- Rregullore për “Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë së Tiranës.

2.4.4. Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- “Competence Requirements in Early Childhood Education and Care” - European Commission, Directorate - General for Education and Culture;
- Council of Europe Strategy for the Rights of the Child 2016-2021;
- Unicef Albania;
- Quality matters in early childhood education and care-Sæden 2013.

2.5 Piramida e pyetjeve audituese



2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit

Për të vendosur mbi qasjen që do të ndiqet në këtë auditim, jemi bazuar në të dhënat e grumbulluara, komunikimet me institucionet e përfshira në zbatimin e politikave për zhvillimin parauniversitar, rregulloret e funksionimit të Bashkisë Tiranë, QEZHEF-it, Bashkisë Vlorë, Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, Rregulloret e Funksionimit të çerdheve e kopshteve, etj. Duke qenë se grupi i auditimit ka vënë në fokus shqyrtimin elementëve si cilësia dhe ruajtja e ushqimit në çerdhe e kopshte, zbatimi i standardeve të hapësirave për fëmijët, sigurisë së tyre, si dhe shërbimin mjekësor dhe psiko-social, qasja audituese do të jetë e orientuar kah rezultatit, duke analizuar dhe konkluduar mbi punën e kryer në drejtim të përmbushjes së objektivave të vendosur për këtë qëllim, për periudhën 2017-2018. Për të arritur në konkluzione dhe rekomandime, puna audituese do të përmbajë elementë analitikë dhe krahasues.

2.5.2 Metodatat/teknikat audituese

Metodat e përdorura janë si vijon:

- Studim gjithëpërfshirës i kuadrit rregullator vendas dhe të huaj, rregulloreve, manualeve dhe kriterëve e praktikave të tjera më të mira;
- Mbledhje, shqyrtim dhe analizim i dokumentacionit gjatë fazës së terrenit të auditimit;
- Takime dhe intervista me drejtues dhe stafin e institucioneve të përfshira në auditim, si dhe me OJF të përfshira në këtë çështje dhe përpunimi dhe analizimi i përgjigjeve të tyre;
- Vizita në terren, për të parë më konkretisht aktivitetet dhe problematikat që hasen në çështjen në fokus;
- Hartimi i pyetësorëve me shkrim për palët e përfshira dhe analizimi i përgjigjeve të tyre;
- Vlerësimi dhe analizimi i feedback –ut të marrë për të arritur në konkluzione.

2.6 Rezultatet e parashikuara

2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë

Nëpërmjet auditimit, Kuvendi dhe Qeveria do të njihen me situatën aktuale dhe progresin e bërë në garantimin e shërbimeve sa më cilësore në kopshte dhe çerdhe, si dhe me problematikat që shtrohen në këtë proces. Rezultatet e këtij auditimi do të kenë impakt të veçantë për Kuvendin dhe Qeverinë, si përdoruesit primarë të raportit të auditimit, ku rekomandimet e lëna do të ndihmojnë vendimarrjen për hartimin e politikave të mëtejshme dhe ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin e situatës, duke promovuar shërbime të kënaqshme e sipas standardeve bashkëkohore.

2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit

Nëpërmjet këtij auditimi, publiku pritët të njihet me përpjekjet dhe arritjet e deritanishme në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga këto institucione, si dhe me fushat ku ende ka mangësi në progresin e kësaj çështje. Nëpërmjet raportit të auditimit, palët e interesit dhe veçanërisht prindërit do të njihen me një dokument të përmbledhur me elementë të të drejtave që duhet të gëzojnë fëmijët në institucionet parashkollore dhe në këtë mënyrë, ky raport do të shërbejë si një mundësi reflektimi për të kërkuar më tej këto të drejta që iu takojnë.

2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit do të përgatitet Projekt-Raporti i Auditimit, i cili do t'i dërgohet Bashkisë Tiranë, QEZHEF dhe Bashkisë Vlorë. Pas marrjes së opinionëve dhe vlerësimit të tyre do të përgatitet Raporti Final i Auditimit, i cili do t'i përcillet përsëri subjekteve dhe

do publikohet në faqen ëeb të KLSH-së, në faqen Facebook të Departamentit të Performancës në KLSH, shtypin e përditshëm apo dhe ëorkshope të ndryshme dhe analiza vjctore të institucionit.

3. Shtjellimi i pyetjeve dhe nën pyetjeve të auditimit

Mesazhi

Bashkitë Tiranë dhe Vlorë nuk kanë arritur të garantojnë një shërbim efektiv në kopshte dhe çerdhe. Sa i takon Bashkisë Tiranë, për çështjet që administrojnë, përpjekjet janë bërë vetëm në drejtim të rikonstruksionit të godinave, ndërkohë që në Vlorë gjendja paraqitet e mjerueshme. Pothuaj të gjithë elementët që garantojnë mirë rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve janë jashtë standardeve, duke filluar që nga mungesa e hapësirave të përshtatshme, mbi popullimi tej kapaciteteve, raporti i cënuar edukator/fëmijë, kushtet higjieno-sanitare, inekzistenca e shërbimit të mjekut dhe psikologut me përjashtim të çerdheve të Tiranës, etj. Në një kohë kur vendet që ne synojmë të kemi shembull i kanë përqendruar tashmë përpjekjet vetëm drejt përsosjes së teknikave edukuese dhe zhvilluese të fëmijës, vendi ynë ende nuk ju siguron dot kushtet elementare të nevojshme për qëndrimin në një institucion “përgjegjës për të ardhmen”. Ndërkohë, për periudhën objekt auditimi evidentohen përmirësime të dukshme sa i takon kompetencave që ka QEZHEF.

3.1 A është i plotë dhe bashkëkohor kuadri rregullator i cili orienton funksionimin e çerdheve dhe kopshteve?

3.1.1 A mbështetet shërbimi në çerdhe dhe kopshte në objektiva strategjike të mirë përcaktuara dhe standarde bashkëkohore?

Strategjia e Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022 është instrumenti më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor i cili synon të sigurojë një zhvillim të qendrueshëm, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet një manaxhimi të suksesshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqënies së qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.¹⁷ Në këtë dokument, identifikohet vetëm një objektiv strategjik sa i përket çerdheve dhe kopshteve, i cili lidhet me sigurimin e infrastrukturës. Ky objektiv përkethehet në një plan pune të ndarë në ndërtimin e 8 çerdheve dhe 7 kopshteve të reja nëpërmjet PPP, si dhe në ndërhyrjet e nevojshme infrastrukturore në 2 çerdhe dhe 11 kopshte ekzistuese¹⁸ deri në vitin 2020. Në këtë dokument nuk identifikohet asnjë prioritet tjetër strategjik që lidhet me të gjithë gamën e shërbimeve që ofrohet nga Bashkia apo QEZHEF, qoftë kjo në logjistikë, shëndetësi, ushqim, etj. Krahas kësaj, nga grupi i auditimit evidentohet se nuk ka një kuadër ligjor e rregullator të posatshëm që orienton dhe përcakton ofrimin e të gjithë shërbimit në çerdhe dhe kopshte, që nga përcaktimi i organeve administruese, e në vazhdim me ato pjesëmarrëse në këtë proces, si dhe ato monitoruese. Nga auditimi vihet se sa i takon dokumenteve strategjike, Bashkia Tiranë e sheh veten të veçuar nga QEZHEF (të cilin e ka institucion varësie), pasi me përjashtim të një objektivi të vetëm strategjik që lidhet me detyrimin e saj të drejtpërdrejtë (atë të garantimit të infrastrukturës), nuk parashikon dhe as kërkon nga QEZHEF studimin dhe hartimin e objektivave strategjike zhvillimore afatgjata

¹⁷ Strategjia e Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022

¹⁸ Strategjia e Zhvillimit të Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, Tabela nr. 30

lidhur me elementët e tjerë të shërbimit që këto institucione ofrojnë. Nga ana e saj, QEZHEF e mbështet veprimtarinë në 5 objektiva pothuajse të njëjtë vit pas viti, të cilat bëhen prezent në analizën vjetore të punës së QEZHEF dhe merren në analizë në vitin pasardhës, përsëri gjatë kësaj veprimtarie. Nga dokumentacioni që u vu në dispozicion, vihet re se asnjë nga objektivat e parashikuar nuk përmban indikatorë performance të matshëm dhe po kështu, gjatë analizës vjetore të vitit pasardhës, për secilin objektiv pasqyrohen në formë përshkruese dhe të përgjithshme veprimet e ndërmarra por nuk pasqyrohen rezultate apo impakte të këtyre veprimeve. E njëjtë paraqitet situata edhe sa i përket Bashkisë Vlorë, e cila nuk ka asnjë prioritet apo objektiva strategjike për garantimin e një shërbimi sa më efektiv në kopshte dhe çerdhe. Mangësia kryesore që vihet re në këtë institucion, buron që nga forma e organizimit dhe rëndësia që i është kushtuar këtij shërbimi, pasi çerdhet dhe kopshtet në këtë qytet administrohen nga dy drejtori të cilat nuk kanë asnjë lidhje me këtë çështje, por që krahas detyrimeve dhe përgjegjësive prioritare që ato kanë, mbulojnë edhe shërbimin në kopshte dhe çerdhe. Kjo mangësi rezultoi edhe gjatë zhvillimit të pyetësorëve dhe intervistave me përfaqësues të Bashkisë Vlorë, gjatë të cilëve të intervistuarit njohin si kuadër ligjor dhe rregullator që orienton realizimin e misionit të Bashkisë sa i takon menaxhimin të çerdheve dhe kopshteve, ligjin për arsimin parauniversitar. Për sa më lart, rezultoi se, nga pikëpamja e kuadrit rregullator, asnjë nga Bashkitë nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur këtij shërbimi kaq të rëndësishëm, duke mos e konsideruar zhvillimin e këtij shërbimi si një prioritet strategjik dhe duke mos e mbështetur atë në objektiva afatgjata të mirë përcaktuara. Për periudhën objekt auditimi, administrimi i këtij shërbimi ka qenë tepër kompleks, sidomos sa i takon kopshteve. Konkretisht për garantimin e shërbimit në këto institucione angazhohen:

- Bashkia e qytetit, e cila është përgjegjëse për garantimin e kapaciteteve, mirëmbajtjes dhe investimeve në godina;
- QEZHEF, e cila është përgjegjëse për garantimin e ushqimit, materialeve të higjienës, si dhe pajisje dhe orëndi; Në rastin e Bashkisë Vlorë shërbimet e sipërpërmendura garantohen nga kjo Bashki.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila për periudhën objekt auditimi ka qenë përgjegjëse për emërimin e stafit të kopshteve, si dhe hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve të edukimit;
- Ministria e Shëndetësisë, e cila është përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e menuesë ushqimore sipas moshës dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor nëpërmjet vizitave apo monitorimit të zhvillimit të fëmijëve.

Për sa më lart, rezultoi se administrimi i çerdheve dhe kopshteve në vendin tonë është ekstremisht heterogjen dhe në shumë raste vihet re një mungesë bashkëpunimi nga aktorët e përfshirë, kryesisht në dhënien e feedback për QEZHEF nga ana e organeve monitoruese. Një nga rastet problematike të diskutuara edhe me stafin e QEZHEF është bashkëpunimi me Operatorin Shëndetësor Vendor Tiranë, i cili është mjeku që ofron shërbimin shëndetësor në kopshte dhe çerdhe. Kjo strukturë, duke patur varësi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk tregohet e disponueshme për të ndarë feedback apo të dhëna të vazhdueshme me mjekun e QEZHEF. Edhe nga realizimi i pyetësorëve rezultoi se mjeku i OSHVT punon sipas një grafiku të miratuar nga OSHVT (kryesisht 1 herë në javë) ndërsa mjeku i QEZHEF monitoron çdo ditë. Disa nga fushat e monitorimit janë të përbashkëta dhe mjeku i OSHVT megjithëse kërkon informacion nga mjeku i QEZHEF, nuk bën të njëjtën gjë anasjelltas. Ndërkohë që mjeku i QEZHEF nuk ka kompetencat e duhura për kërkesë informacioni apo llogaridhënie në rast se nevojitet.

Në rastin e Bashkisë Vlorë nuk ka fare një mjek përgjegjës për monitorimin e aspekteve shëndetësore apo zhvillimore të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe. Duke marrë parasysh se qëllimi parësor i strukturave administrative të kopshteve dhe çerdheve është mirë rritja dhe zhvillimi i fëmijëve, mungesa e bashkëpunimit dhe anashkalimi i këtyre institucioneve nga njësitë e ndryshme monitoruese të zhvillimit apo shëndetit, do ta cënontë këtë qëllim. Po kështu, gjatë auditimit rezultoi se për periudhën objekt auditimi, periudhë gjatë të cilës rekrutimi i stafit të kopshteve ishte kompetencë e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, komisionet e monitorimit të QEZHEF mund të kryenin monitorime vetëm për cilësinë e ushqimit, apo higjienën në kuzhinë, shërbime të cilat i garantonin vetë. Nga stafi i QEZHEF u deklarua se për raportet e monitorimit të dërguara drejt MASR nuk ka patur feedback për vendime apo masa të marra. Lidhur me pyetjen mbi nevojën për përafrime të kuadrit rregullator me atë të BE, QEZHEF vlerëson se i gjithë kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e saj, është i përafëruar me parimet e përgjithshme të kuadrit ligjor e rregullator të BE-së edhe pse veprimtaria administrative dhe detyrimet konkrete të këtij institucioni karshi çerdheve dhe kopshteve gjenden të pasqyruar vetëm në një dokument rregullator, atë të Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të këtij institucioni. Ndërkohë që lidhur me të njëjtën pyetje, përfaqësues të Bashkisë Tiranë e njohin çështjen e përafrimit të kuadrit ligjor e rregullator me atë të BE, thjesht si aderim dhe zbatim të Konventave Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Edhe në rastin e Bashkisë Vlorë, nuk rezultoi të jetë marrë në analizë nevoja për përmirësime ligjore apo përafrime me kuadrin rregullator të BE. Lidhur me çështjen e garantimit të të drejtave të fëmijëve, në pyetësorët e zhvilluar Bashkia Tiranë pohon se QEZHEF ushtron funksionet e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku ndër të tjera liston Rregulloren e funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijët në nevojë në qendrat ditore publike dhe jo publike. Nga shqyrtimi i këtyre akteve vihet re se në përmbajtjen e tyre nuk ka asnjë detyrim apo përgjegjësi për QEZHEF, ndërkohë që nga pikëpamja e garantimit të të drejtave të fëmijës nga auditimi rezultoi se në gjithë procesin administrues të kopshteve dhe çerdheve nuk është prezent as ASHMDF, as Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës pranë Bashkisë dhe as institucioni i Avokatit të Popullit në cilësinë e aktorëve kryesor të garantimit të mbrojtjes së këtyre të drejtave. Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve vihet re se ligji e vë theksin më tepër drejt trajtimit dhe marrjes së masave për rastet e shkeljes së tyre, pra është më i orientuar drejt veprimeve pas faktit dhe nuk fokusohet në kryerjen e monitorimeve të vazhdueshme për të shmangur arritjen në fazën kur fëmija është kthyer në një “subjekt në nevojë”. Organet kryesore përgjegjëse të përmendura më lart angazhohen më tepër për trajtimin e këtyre fëmijëve. Rastet në media kanë treguar se shpesh në kopshte apo çerdhe janë regjistruar edhe raste të dhunës, të cilat u hasën dhe në formën e ankesave të prindërve në një nga dosjet e psikologëve të vëna në dispozicion. Megjithatë monitorimet kanë munguar për sa i përket këtij fenomeni, si pasojë edhe e mungesës së përcaktimeve të qarta se cilët janë organet monitoruese, linjat e raportimit për këto raste, etj. Për rastin konkret në fjalë, nga auditimi u vu re se kjo ankesë është trajtuar vetëm me mjekun dhe psikologun e QEZHEF dhe nuk është bërë prezent në hallka të tjera kompetente që trajtojnë rastet e dhunës. Në fushën e inspektimeve, vihet re gjithashtu se kopshtet dhe çerdhet kanë qenë larg vëmendjes edhe të Inspektoriatit të Përgjithshëm të Inspektimeve, nga raportet e publikuara në ëeb të të cilit vihet re se fokusi maksimal është mbi shkollat, ndërkohë që edhe në një inspektim të vetëm të kryer në kopshte mbi sigurinë e instalimeve elektrike, raportimi është shumë i

përgjithshëm dhe nuk identifikohen subjektet në të cilat kanë ndodhur 12 incidente, apo mënyra si janë adresuar më tej këto raste.

Në opinionin e grupit të auditimit, këto mangësi vijnë si pasojë e mungesës së një kuadri rregullator apo protokolleve të bashkëpunimit me përgjegjësi menaxhuese dhe koordinuese të përcaktuara qartë. Në tërësi nga auditimi nuk rezultuan gjurmë zbatueshmërie të asnjë strategjie apo objektivash të tillë, me gjithë kompleksitetin e aktorëve të përfshirë në këtë fushë.

Lidhur me rregulloret dhe standardet që aplikohen për ofrimin e shërbimit në kopshte dhe çerdhe ato renditen si më poshtë:

- Rregullore higjieno-sanitare për ndërtimin dhe funksionimin e kopshteve të fëmijëve nr. 1610 prot, datë 17.05.1995, e cila mbështet në një kuadër rregullator dhe struktura shumë të hershme. Pavarësisht se kjo rregullore i kushtohet çështjeve higjieno-sanitare, në përmbajtje ajo trajton edhe shumë aspekte infrastrukturore, standarde kapacitetesh, hapësirash, sigurie, çështje të edukimit etj. Po kështu, në këtë rregullore ndalohet përdorimi i gazit në ambientet e këtyre institucioneve, ndërkohë që në ditët e sotme gazi është kthyer në mjetin kryesor të konsumit;
- Rregullore e shërbimit shëndetësor në çerdhe nr. 2370, datë 09.06.1998 gjithashtu shumë e hershme, e cila përmban detyrat dhe përgjegjësitë e mjekut në çerdhe (në atë kohë inspektori i nënës dhe fëmijës), krahas vizitave dhe vlerësimeve shëndetësore që duhet të kryen për fëmijën, parashikon edhe kontrolle për çështjet higjieno-sanitare;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore parashkollore nr. 313, datë 17.02.2005, ku ndër të tjera parashikohen dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e ndihmës kuzhineres, përgjegjësi e cila i takon QEZHEF;
- VKM nr. 530, datë 20.07.2016 për miratimin e “Standardeve të projektimit të çerdheve”, i cili përmban të gjithë hapësirat dhe elementët e nevojshëm që duhet të plotësojë një çerdhe në funksion të ofrimit të një shërbimi sa më efektiv. Në këtë dokument, hasen edhe elementë nga dokumente të sipërcituara sa i takon infrastrukturës;
- Standardet e projektimit të kopshteve, dokument i cili ka të njëjtin funksion si ai i çerdheve dhe që në shumë kapituj përputhen plotësisht;
- Rregullore e funksionimit të çerdheve nr. 1758, datë 04.12.2017 e cila orienton funksionimin dhe veprimtarinë e administratës dhe stafit të çerdheve.

Nga konsultimi me këtë dokumentacion rezultoi se një pjesë e standardeve që aplikohen në fushën e menaxhimit të kopshteve dhe çerdheve janë shumë të hershëm dhe hartimi i tyre është mbështetur në një kuadër rregullator dhe struktura të cilat kanë ndryshuar ndër vite, e megjithatë këto dokumente ende nuk janë shfuqizuar. Gjithashtu vihet re se ka përsëritje por edhe nevojë për përditësim në shumicën prej tyre, për shembull në rastin e përdorimit të gazit siç u theksua më lart, apo elementë të cilët gjenden në disa dokumente standardesh njëherësh, ku në disa raste janë edhe jashtë fushës së çështjes që trajton ai dokument. Megjithëse gjatë pyetësorëve të realizuar, stafi i QEZHEF u shpreh se nuk është kompetencë e tyre përditësimi i rregulloreve higjieno-sanitare, në cilësinë e garantuesit kryesor të higjienës brenda kopshteve dhe çerdheve, nga pikëpamja e performancës ky institucion së bashku me Bashkinë Tiranë duhet të jenë iniciator dhe lobues për përditësimin e çdo dokumenti që prek çështje brenda kopshteve dhe çerdheve. Ndërkohë, sa i takon përsëri standardeve të nevojshme për garantimin e mirë rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve, nga të dyja Bashkitë rezulton se ende nuk janë hartuar Standardet e Zhvillimit,

Përkujdesjes dhe Mirërritjes së Fëmijëve, si dhe Programet e Prindërimit në Komunitet, siç parashikohet në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020. Aktualisht specialistët e sektorit psiko-social pranë QEZHEF ndihmojnë prindërimin pozitiv, duke përgatitur materiale informuese dhe fletëpalosje të cilat i janë shpërndarë prindërve me qëllim rritjen e informimit dhe kujdesit prindëror. Përveç materialeve informuese dhe këshilluese, të cilat i referohen praktikave më të mira (sipas studimeve) psikologu kryen edhe takime me prindër në çerdhe lidhur me sa më lart.

Gjetje:

- ✓ Pavarësisht gamës së gjerë të shërbimit që mbulojnë kopshtet dhe çerdhet, Bashkia Tiranë dhe Vlorë nuk kanë dokumente me prioritete strategjike për këtë çështje, me përjashtim të një objekti të vetëm në Strategjinë e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, i cili lidhet vetëm me shtimin e kapaciteteve.
- ✓ Asnjë nga objektivat e QEZHEF nuk përmban indikatorë performace të matshëm ndërkohë që edhe në analizën e punës ato pasqyrohen në formë përshkruese dhe të përgjithshme por nuk pasqyrohen rezultate apo impakte të këtyre veprimeve.
- ✓ Në Bashkinë Vlorë çerdhet dhe kopshtet administrohen nga dy Drejtori të ndryshme dhe jo në formë të unifikuar, të cilat kanë funksione dhe qëllime krejtësisht të ndryshme dhe larg atyre të administrimit të kopshteve dhe çerdhe..
- ✓ Ka mangësi në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve me njësitë vendore nga ana e organeve të ndryshme që kryejnë inspektime apo monitorime.
- ✓ Një pjesë e standardeve që aplikohen në fushën e menaxhimit të kopshteve dhe çerdheve janë shumë të hershëm dhe hartimi i tyre është mbështetur në një kuadër rregullator dhe struktura të cilat kanë ndryshuar ndër vite, e megjithatë këto dokumente ende nuk janë shfuqizuar.
- ✓ Ende nuk janë hartuar Standardet e Zhvillimit, Përkujdesjes dhe Mirërritjes së Fëmijëve, si dhe Programet e Prindërimit në Komunitet, siç parashikohet në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020

Konkluzione:

- ✓ Asnjë nga Bashkitë nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur efektivitetit të këtij shërbimi kaq të rëndësishëm, duke mos e konsideruar zhvillimin e tij si një prioritet strategjik dhe duke mos e mbështetur atë në objektiva afatgjata të mirë përcaktuara.
- ✓ Shërbimi në çerdhet dhe kopshtet e vendit tonë është ekstremisht heterogjen dhe në shumë raste vihet re një mungesë bashkëpunimi nga aktorët e përfshirë, kryesisht në dhënien e feedback nga monitorimet, duke cënuar në këtë mënyrë eficiencën e këtij shërbimi.
- ✓ Bashkia Vlorë ka një formë të pa përshtatshme dhe aspak efektive organizmi sa i takon ofrimin të shërbimit në kopshte dhe çerdhe, duke i bërë pjesë këto institucione të Drejtorive të cilat në thelb kanë prioritete krejtësisht të ndryshme nga çështja në fjalë.
- ✓ Nuk ka koherencë në hartimin e kuadrit rregullator që orienton menaxhimin e çerdheve dhe kopshteve, pasi ky proces fokusohet në aspekte të veçanta pa marrë në konsideratë edhe nevojën për përditësimin e të gjithë setit normativ që lidhet me këtë çështje, duke cënuar në këtë mënyrë eficiencën e këtij procesi.

Rekomandime:

- ✓ Bashkia Tiranë, QEZHEF dhe Bashkia Vlorë të marrin masa për hartimin e politikave konkrete zhvillimore dhe të mbështesin punën e tyre sa i takon administrimit të kopshteve dhe çerdheve në objektiva strategjike afatgjata SMART të cilat të përfshijnë të gjithë elementët e shërbimit që garantohen nga këto organe.

Brenda vitit 2020

- ✓ Bashkia Vlorë të marrë masa për rishikimin dhe riorganizimin e strukturës së saj, duke i dedikuar një vend të rëndësishëm në organikë një sektori të posatshëm i cili ti dedikohet të gjithë çështjeve të administrimit të kopshteve dhe çerdheve brenda përgjegjësisë që buron nga Ligji për vetë qeverisjen vendore.

Brenda vitit 2020

- ✓ Bashkia Tiranë nëpërmjet sektorëve të hartimit të politikave, në bashkëpunim me QEZHEF nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kujdesit, si dhe Bashkia Vlorë të marrin masa për hartimin e protokolleve të bashkëpunimit me aktorët e tjerë të përfshirë në procese monitoruese, inspektuese apo vendimarrëse, ku të përcaktohen qartë aspektet e koordinimit dhe shkëmbimit të ndërsjellët të informacioneve të nevojshme në kuadër të ofrimit të një shërbimi sa më eficient në kopshte dhe çerdhe.

Brenda 6 mujorit 2020

- ✓ Bashkia Tiranë, QEZHEF dhe Bashkia Vlorë të jenë iniciatorë dhe lobues lidhur me procesin e përditësimit të standardeve apo rregulloreve që aplikohen në administrimin e çerdheve dhe kopshteve, si dhe hartimin e një dokumenti standardesh gjithëpërfshirës dhe të unifikuar mbi këtë çështje.

Në vazhdim

3.1.2 A janë të qarta dhe transparente përgjegjësitë dhe detyrimet e subjekteve nën auditim?

Kuadri ligjor e rregullator është një element kyç, pasi ai parashikon mënyrën si trajtohen dhe kuptohen problemet, krijon strukturat dhe mekanizmat, dhe përcakton përgjegjësitë, strategjitë, veprimet, procedurat dhe standardet që duhet të ndiqen brenda një sistemi. Për rastin e administrimit të çerdheve dhe kopshteve rezulton se kuadri rregullator kryesor që orienton këtë shërbim mbështetet në aktet normative si më poshtë:

Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i cili përcakton Bashkitë si organet kryesore përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe, por asnjë përcaktim tjetër se si do të kryhet ky proces. Në zbatim të kompetencave të saj, Bashkia Tiranë ka ngritur Qendrën Ekonomike për Zhvillimin dhe Edukimin e Fëmijëve, si organin përgjegjës për ofrimin e shërbimit ushqimor, edukues dhe logjistik në kopshte dhe çerdhe, ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike janë përgjegjëse për çështjet e infrastrukturës. Në rastin e Bashkisë Vlorë menaxhimi i të gjithë shërbimit bëhet nga vetë Bashkia nëpërmjet Drejtorive të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Shëndetit Publik për administrimin e çerdheve dhe asaj të Koordinimit të Projekteve dhe Investimeve të Huaja për kopshtet, si dhe të Qendrës Ekonomike si njësi shpenzuese.

Rregullore e Brendshme e QEZHEF, e cila përcakton mënyrën e funksionimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e këtij institucioni në funksion të garantimit të një shërbimi sa më eficient ushqimor, shëndetësor dhe logjistik në kopshte dhe çerdhe.

Ligji nr. 18/2017, datë 23.02.2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që

garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ligji nr. 10221, datë 4.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili garanton trajtim të barabartë dhe mbrojtje nga çdo formë diskriminimi të fëmijëve në lidhje me gjininë, racën, gjendjen ekonomike, përkatësinë prindërore, etj.

Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili për periudhën objekt auditimi përcakton kompetencat për punësimin e stafit drejtues dhe edukatoreve në kopshte.

Rregullore e Brendshme Bashkia Vlorë, e cila përcakton mënyrën e funksionimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e këtij institucioni dhe ndër të tjera dhe të njësive përgjegjëse për garantimin e shërbimit në çerdhe dhe kopshte.

Krahas këtij seti rregullator parësor dhe si pasojë e një menaxhimi kompleks nga shumë aktorë të tjerë të kopshteve dhe çerdheve, ky shërbim ndikohet dhe nga akte të tjera normative apo standarde si ato në fushën e shëndetësisë, arsimit, higjienës, etj. Si pasojë e këtij kompleksiteti, gjatë auditimit u vu re se në shumë raste ka mungesë transparence, keqkuptime apo paqartësi në përcaktimin e detyrave për secilin organ që ushtron një funksion mbi këtë shërbim si vijon.

Objektivat e QEZHEF nuk lidhen fare me fushën e saj të përgjegjësisë. Nga auditimi rezultoi se në mungesë të një strategjie kombëtare me prioritete strategjike gjithë përfshirëse dhe me detyra të ndara qartë për menaxhimin e çerdheve dhe kopshteve, QEZHEF harton objektivat e saj për vitin pas ardhës vetëm gjatë kryerjes së analizës së veprimtarisë vjetore. Në këto dokumente u konstatua se ndër objektivat e parashikuara të QEZHEF renditen rikonstruksioni i godinave dhe ndërtimi i atyre të reja, të cilat pavarësisht se nuk kanë përcaktime sasiore të matshme për sa godina bëhet fjale, por gjithashtu nuk janë as një detyrim i QEZHEF dhe realizimi i këtyre objektivave nuk varet fare nga kjo njësi por nga Ndërmarrja e Punëtorëve të Qytetit nr. 3 pranë Bashkisë. Po në këtë dokumentacion renditen objektiva që lidhen me ndryshime në menunë ushqimore dhe konkretisht parashikohet përfshirja e sa më shumë perimeve dhe frutave të stinës në menu. Përsëri edhe në këtë rast aplikimi i ndryshimeve në menunë ushqimore është detyrë dhe përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Theksojmë se QEZHEF nëpërmjet specialistëve të saj, apo rasteve të sugjerimeve nga prindët, përfshihet në konsultime dhe diskutime për mundësinë e ndryshimeve në menu në grupet e punës që ngrihen për këtë qëllim, megjithatë miratimi përfundimtar i menuve ushqimore në kopshte dhe çerdhe është përgjegjësi e MSHMS. Në këtë kontekst edhe objektivi i shtimit të sa më shumë frutave apo perimeve të stinës çënon zbatimin e menus por edhe mirë rritjen e fëmijëve, pasi në menunë ushqimore të miratuar nga MSHMS janë të përcaktuara qartë llojet e frutave dhe perimeve, por edhe gramatura e saktë e nevojshme për tu konsumuar nga secili. Për këtë arsye QEZHEF nuk mund të ndërhyjë as në llojshmërinë dhe as në sasinë e ofruar e produkteve ushqimore. Përgjegjësia e QEZHEF në këtë rast e cila përcaktohet edhe në rregulloren e saj të funksionimit, është monitorimi i cilësisë dhe pastërtisë së gatimeve dhe zbatimi me rigorozitet i menusë ushqimore. Në aspektin e menusë ushqimore, vihet re gjithashtu se ajo është hartuar në kushtet ideale shëndetësore të fëmijës dhe nuk ka asnjë përcaktim të qartë se si veprohet për rastet e fëmijëve me intolerancë ushqimore apo alergji të ndryshme. Gjatë vizitave që grupi i auditimit zhvilloi në kopshte dhe çerdhe, u konstatua se në këto raste veprohej nga edukatorët sipas mendimit të tyre ku një ushqim zëvendësohej me një tjetër.

Një tjetër problem shqetësues sa i takon transparencës së detyrimeve lidhet me tarifimin dhe kostot e çdo prindi në çerdhe dhe kopshte. Tarifatat për frekuentimin në çerdhe dhe kopshte

përcaktohen me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe në këtë vendim përcaktohet se kjo tarifë mbulon ushqimin dhe paguhet një herë në muaj në varësi të ditëve që fëmija ka frekuentuar kopshtin ose çerdhen. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni vihet re se në të dy rastet Tiranë dhe Vlorë, ky vendim nuk shoqërohet me asnjë studim apo përlllogaritje të kostove apo elementëve të marra në konsideratë për arritjen në këtë tarifë përfundimtare. Ajo çka bie në sy në të dy Bashkitë, është se tarifa në të dyja rastet është e njëjtë (130 lek/ditë për çerdhet dhe 160 lek/ditë për kopshtet) pavarësisht se niveli i jetesës dhe të ardhurave në këto dy qytete është ekstremisht i ndryshëm. Krahas kësaj mungese transparence, nga auditimi në kopshte dhe çerdhe rezultoi se gjatë vitit shkollor, prindërit përballen me “kosto të fshehura” për pjesën më të madhe të nevojave që ka një shërbim i tillë. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që administrojnë përgjegjësit e kopshteve dhe çerdheve, u vu re se rregullisht në këto institucione mblidhen kontribute nga prindërit të cilët sigurojnë, ujin e pijshëm, mjetet didaktike të përditshme të fëmijës (letra, lapsa, ngjyra, lodra, plastelina, gërrshërë e shumë mjete të tjera) pajisje dhe orendi të tjera si lavatriçe, frigoriferë, soba ngrohje apo riparimi i tyre, arredime të ndryshme, etj. Ky fenomen u has më i reduktuar në Bashkinë Vlorë, ku për shkak edhe të nivelit më të ulët të të ardhurave, prindërit siguronin kryesisht mjetet didaktike, në pamundësi për orendi të tjera, ndërkohë nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Vlorë vetëm për vitin 2018 ka planifikuar një fond prej 1,050,000 lekë vetëm për hedhje fishekzjarresh në 3 evente të ndryshme, shumë e cila do të vinte jashtëzakonisht në ndihmë përmirësimit të kushteve në kopshte dhe çerdhe. Pavarësisht se dhënia e ndonjë donacioni nga prindët parashikohet në rregulloren e funksionimit të QEZHEF, ky fenomen është kthyer në një procedurë të rregullt mujore për elementë të cilët ka detyrimin për ti siguruar Bashkia e qytetit. Po kështu, në shumë raste u konstatua se shpenzimet e kryera jo gjithmonë shoqëroreshin me faturat përkatëse, ndërkohë që fondet e mbledhura administrohen herë nga përgjegjësit e kopshtit/çerdhes dhe herë nga bordi i prindërve dhe në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi për administrimin e cash-it.

Së fundmi, sa i takon transparencës dhe mirë përcaktimeve të detyrimeve për njësitë përgjegjëse në administrimin e kopshteve dhe çerdheve, nga auditimi u konstatua se ka paqartësi apo dhe mbivendosje në përmbajtjen e standardeve apo rregulloreve të aplikueshme në shërbimin në kopshte dhe çerdhe, si dhe në organet të cilat i monitorojnë ato. Kështu vihet re se udhëzime për çështje të mjedisit, sigurisë, ushqimit apo higjienës gjenden njëherësh në disa dokumente të tilla si, Udhëzuesi i Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar ashtu dhe në Standardet e projektimit të kopshteve apo çerdheve. Në Standardet e Projektimit si për kopshtet ashtu dhe për çerdhet nuk përcaktohet se kush do të jetë organi monitorues i zbatimit të këtyre standardeve, ndërkohë që për kopshtet IKAP kryen inspektime të këtyre standardeve sipas dokumentit të sipër cituar të lëshuar nga vetë ata. Po kështu paqartësi ka lidhur me procesin e ruajtjes së kampionëve të ushqimit për 24 orë, ku sipas inspektoriatit të arsimit ruhen në frigoriferë, ndërsa sipas rregullores higjieno-sanitare ato ruhen në dollapë. Në asnjë nga dokumentet nuk përcaktohet qartë në cilën temperaturë duhet të ruhen këto kampionë, për të ruajtur nivelin e duhur të fermentimit mbas 24 orësh. Paqartësi vihet re gjithashtu në kriteret për shpërndarjen dhe grupimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe, për të cilin gjenden direktiva kontradiktore mes dokumentit Standardet e Projektimit të Kopshteve dhe Udhëzimit nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në arsimin parauniversitar”, në të cilin thuhet se në kopshte numri i fëmijëve në grup nuk duhet të jetë më pak se 25. Krahas kontradiktës me Standardin e projekteve të kopshteve i cili

përcakton numër të ndryshëm fëmijësh në grupe të ndryshme, përcaktimi i udhëzimit të MASR mund të lerë vend për abuzim duke mos përcaktuar një kriter tavan për numrin e fëmijëve në një grup.

Për sa më lart vihet re se hartimi i udhëzuesve apo standardeve bëhet me iniciativa individuale të institucioneve të ndryshme sipas fushës së përgjegjesisë, duke mos marrë parasysh dokumentet ekzistuese apo të cilat i përfshijnë tashmë këto elementë, si dhe duke shmangur bashkëpunimin për unifikimin e tyre. Në Shqipëri, koordinimi mbetet një fushë që nuk është tërësisht funksionale dhe minohet nga aspekte teknike, strukturore dhe të sjelljes. Në pjesën më të madhe, ai merr formën e shkëmbimit të informacionit, në vend që të jetë një vendimmarrje dhe ndarje pune efektive dhe kolektive.¹⁹

Gjetje:

- ✓ QEZHEF harton objektiva për ndërtimin e godinave të reja të kopshteve dhe çerdheve, apo ndërhyrje në menunë ushqimore, përgjegjësi të cilat janë përkatësisht të Bashkisë Tiranë dhe MSHMS.
- ✓ Menuja ushqimore që aplikohet në kopshte dhe çerdhe nuk ka asnjë përcaktim të qartë se si veprohet për rastet e fëmijëve me intolerancë ushqimore apo alergji të ndryshme.
- ✓ Krahas tarifës së ushqimit, pjesën më të madhe të nevojave në kopshte dhe çerdhe e garantojnë prindërit dhe jo Bashkia të cilët paguajnë për ujë, lodra, mjete didaktike, pajisje dhe orendi të tjera si lavatriçe, frigoriferë, soba ngrohje apo riparimi i tyre, arredime të ndryshme, etj. Ky fenomen haset më i reduktuar në Bashkinë Vlorë.
- ✓ Në standardet e ndryshme që aplikohen për shërbimin në çerdhe dhe kopshte ka përcaktime kontradiktore po edhe të përsëritura lidhur me ruajtjen e kampionëve të ushqimit, numrin e fëmijëve në grup, elementë të sigurisë apo mjedisit, etj.

Konkluzione:

- ✓ Përgjegjësia për administrimin e çerdheve dhe kopshteve përmendet vetëm në një fjali në morinë e neneve që përmban Ligji për vetëqeverisjen vendore, por nuk ka asnjë kuadër ligjor që të përcaktojë më tej se çfarë përfshin ky administrim, duke cënuar në këtë mënyrë eficiencën e këtij shërbimi.
- ✓ Objektivat e QEZHEF nuk lidhen fare me fushën e saj të përgjegjesisë, duke vështirësuar në këtë mënyrë matjen e progresit dhe efektivitetit të këtij shërbimi.
- ✓ Gjatë vitit shkollor, prindërit përballen me “kosto të fshehura” për pjesën më të madhe të nevojave që ka një shërbim i tillë si ujë, lodra, mjete didaktike, pajisje dhe orendi të tjera si lavatriçe, frigoriferë, soba ngrohje apo riparimi i tyre, arredime të ndryshme, etj. Vendimet e Këshillit Bashkiak për tarifën nuk shoqërohen me asnjë studim apo përlllogaritje të kostove apo elementëve të marra në konsideratë për arritjen në këtë tarifë përfundimtare në kundërshtim me elementët e ekonomicitetit.
- ✓ Hartimi i standardeve të ndryshme bëhet me iniciativa individuale të institucioneve të ndryshme sipas fushës së tyre të përgjegjesisë duke shkaktuar mbivendosje, përsëritje apo edhe kontradikta në përmbajtjen e tyre, veprime të kryera pa eficiencë.

Rekomandime

¹⁹ <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Hartezimi-dhe-analiza-MAESTRAL.pdf>

- ✓ Bashkia Tiranë dhe Vlorë nëpërmjet sektorëve juridik të marrin masa për nisjen e konsultimeve për nevojën e ngritjes së një kuadri ligjor të veçantë dhe të posatshëm për të gjithë procesin e menaxhimit të kopshteve dhe çerdheve i cili të përcaktojë qartë të gjithë aktorët që duhet të përfshihen në administrimin e kopshteve dhe çerdheve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, fushat e bashkëpunimit dhe inspektimit, mënyrën e llogaritjes së tarifave, rregullat dhe kushtet e regjistrimeve, etj. Për këtë rekomandojmë të merret në konsultim për shembull Ligji i Britanisë së Madhe për administrimin e kopshteve dhe çerdheve. Në këtë kuadër, si dhe duke marrë parasysh gamën e gjerë të elementëve që ofrohen në këto shërbime parashkollore, Bashkia Tiranë të vlerësojë mundësinë e shkëputjes së QEZHEF si një agjenci buxhetore më vete, me rritje të plotë të kompetencave administruese, në mënyrë që të menaxhojë vetë të gjitha nevojat.

Brenda 9 mujorit 2020

- ✓ Bashkia Tiranë dhe Vlorë nëpërmjet Këshillave Bashkiak dhe grupeve të ngirtura për këtë qëllim, të shoqërojnë me studime apo të bëjnë publike përlllogaritjen e kostove apo elementëve të marra në konsideratë për përcaktimin e tarifës së kopshteve dhe çerdheve. Për të shmangur shpenzimet e vazhdueshme dhe të pa dokumentuara të prindërve për nevojat që kanë kopshtet dhe çerdhet, bashkitë e mësipërme të vlerësojnë rigorozisht mundësinë e rritjes së buxhetit të alokuar për këtë shërbim.

Brenda 6 mujorit 2020

- ✓ Bashkia Tiranë, Vlorë dhe QEZHEF, nëpërmjet specilaistëve të financës të marrin në shqyrtim ngritjen e një mekanizmi të posatshëm për administrimin e kontributeve të prindërve në përputhje me aktet ligjore në fuqi për administrimin e cash-it.

Menjëherë

- ✓ Bashkia Tiranë dhe Vlorë dhe QEZHEF të kërkojnë bashkëpunimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për modifikimin e menuesë ushqimore, duke përfshirë edhe rastet e fëmijëve me intoleranca ushqimore, apo alergji të ndryshme.

Menjëherë

3.2 A janë përmbushur me sukses dhe në afate objektivat e vendosura për përmirësimin e shërbimit në çerdhe dhe kopshte?

3.2.1 A është garantuar shërbimi i duhur ushqimor dhe shëndetësor në çerdhe dhe kopshte?

Ushqyerja e shëndetshme ka një ndikim të fortë në fëmijërinë e hershme jo vetëm për shkak të vlerave ushqyese që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e fëmijëve, por edhe në krijimin e një kulture ushqyerje, duke qenë se shumë nga mënyrat e sjelljes formohen në këtë periudhë dhe mbarten gjatë gjithë jetës. Një ushqyerje e shëndetshme forcon gjithashtu edhe mirëqenien sociale, mendore dhe fizike të fëmijëve duke shërbyer si një bazë e fortë në këtë periudhë të rëndësishme zhvillimi. Për këto arsye kemi vendosur në fokus të analizës procedurat e ndjekura në lidhje me furnizimin me produkte ushqimore,

zbatimin e menusë ushqimore, si dhe monitorimin e shërbimit shëndetësor, psiko-social dhe higjieno-sanitar, me qëllim garantimin e nevojave thelbësore të fëmijëve në bashkitë si më poshtë:

Bashkia Tiranë

Në funksion të zbatimit të kontratave të furnizimit me produkte ushqimore, QEZHEF ka hartuar procedurën specifike të Procesit të Rekrutimit të Burimeve Njerëzore, Planifikimit të Fondeve Buxhetore, Realizimit dhe Likuidimit të Kontratave, Planifikimit, Furnizimit dhe Shpërndarjes së Produkteve të Ndryshme Objekt Prokurimi në Çerdhet dhe Kopshtet Publike të Qytetit të Tiranës”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 1103/1 datë 30.12.2016. Referuar rregullores së QEZHEF, si dhe në zbatim të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm, Komisioni i ngritur për verifikimin, kontrollin dhe marrjen në dorëzim të mallrave artikuj ushqimor, çdo ditë kryen procedurën e pritjes, verifikimit, kontrollit dhe marrjes në dorëzim të produkteve ushqimore dhe po kështu edhe furnizimi në çerdhe dhe kopshte kryehet rregullisht çdo ditë sipas menusë së ditës pasardhëse. Referuar kësaj procedure, çdo mall i lëvruar në bazë të porosisë së bërë një ditë më parë, në bazë të frekuencimit ditor të fëmijëve, kontrollohet, verifikohet dhe peshohet nga komisioni i pritjes së mallit, në përbërjen e të cilit janë mercologë, teknologë dhe magazinier. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, nr. 993 datë 31.10.2018, kjo procedurë duhet të kryhet brenda orës 07:30 - 10:00 dhe më pas nis shpërndarja e mallrave në kopshte dhe çerdhe. Nga verifikimi në terren rezultoi se procesi i marrjes në dorëzim të produkteve nuk përfundon në orën 10.00, kjo për shkak të kompleksitetit të procesit dhe kohës relativisht të gjatë që merr vlerësimi i produkteve sipas specifikimeve teknike të përcaktuara. Gjatë këtij verifikimi u konstatua se produktet mish, bulmet dhe vezë mbërrinin të parat në QEZHEF dhe qëndronin në pritje për rreth 3 orë deri në përfundim të gjithë procesit jo në kushte frigoriferike. Një tjetër problematikë e konstatuar lidhet me rastet kur një produkt i caktuar nuk pranohej dhe kthehej mbrapsht kur konstatohej jo në përputhje me specifikimet teknike. Në këtë rast ekziston risku i mos garantimit në kohë të këtij produkti duke qenë se ai nevojitej për ditën pasardhëse. Marrja në dorëzim e produkteve bëhej nga komisioni i ngritur për këtë qëllim me anë të metodës organo-leptike, si dhe duke shqyrtuar fletë analizat përkatëse. Nga verifikimi në terren u konstatua se artikulli bizele vjen në formë të ngrirë duke qenë se nuk është gjithmonë produkt i sezonit, në kundërshtim me parimet e të ushqyerit në mënyrë të shëndetshme, sipas së cilave frutat dhe perimet duhet të jenë të stinës dhe të freskëta. E gjithë sasia e frutave dhe perimeve vjen e ndarë në qese me sasi 1,2,4 për lehtësi të shpërndarjes nga QEZHEF. Nga grupi i auditimit u konstatua se verifikimi i tyre bëhej në mënyrë të nxituar. Në të gjitha rastet e peshimit të këtyre qeseve ky proces nuk u krye nga komisioni por nga shpërndarësit e QEZHEF, të cilët tërhiqnin direkt nga mjeti i furnitorit produktet të cilët një pjesë i peshonin e një pjesë jo, për ti shpërndarë më tej në automjetet përkatëse sipas grafikut të shpërndarjes së secilit. Për verifikimin e zbatimit të menusë ushqimore dhe kushteve higjieno sanitare grupi i auditimit zhvilloi vizita dhe pyetësorë në disa kopshte dhe çerdhe me përzgjedhje rastësore, nga ku rezultoi se në shumicën e tyre menuja e ushqimit ishte e afishuar dhe respektohej. Në kopshtin nr. 6, u konstatua mos respektim i menusë ditore, ku u vu re se përbërësit e sallatës ishin krejtësisht të ndryshëm nga ato të parashikuar në menu. Gjatë vaktit të drekës ushqimi shërbehej me servise të përshtatshëm. Nga vizitat në këto institucione u konstatuan teprica të mëdha të ushqimeve nga vakti. Disa nga ushqimet pjesë e menusë, si sallata me perime të ziera, tërshëra me qumësht, tërshëra me kos etj, nuk

konsumoheshin plotësisht nga fëmijët. Nga dokumentacioni i shqyrtuar kjo problematikë ishte konstatuar edhe nga monitorimet e kryera nga QEZHEF apo edhe nga opinionet e prindërve, megjithatë nuk rezultoi të jetë marrë ndonjë masë për analizimin dhe zgjidhjen e këtij fenomeni.

Për sa i përket garantimit të higjienës, si dhe kushteve të brendshme dhe të jashtme, QEZHEF bazohet në Rregulloren nr. 2370, datë 09/06/1998 për Shërbimin Shëndetësor në Çerdhe, miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Nga vëzhgimi në terren në kopshtet dhe çerdhet e qytetit të Tiranës rezultoi se kushtet e higjienës përgjithësisht ishin optimale si në çerdhe ashtu edhe në kopshte, por u vunë re në disa prej tyre kushte të pa përshtatshme higjienike në ambientet e fjetjes si p.sh në kopshtin nr. 36, ku ambientet e fjetjes ishin me ajër të rëndë që vinte si pasojë e higjienës jo të mirë të dyshekëve dhe lagështisë së pjesshme. Gjithashtu në këtë kopsht ishin lyer ambientet e përbashkëta, korridoret dhe shkallët, ndërsa në ambientet e fjetjes vihej re dukshëm mungesa e lyerjes dhe higjienës. Në pothuajse të gjitha tualetet e kopshteve, që përdorshin nga fëmijët, mungonin peshqirët e duarve të veçantë për çdo fëmijë dhe të personalizuar. Po kështu, një pjesë e tyre ishin shumë të konsumuar dhe të papërshtatshëm për tu përdorur. Në kopshtin nr. 64 në tualetet që përdorshin nga fëmijët peshqirët mungonin. Në kopshtin nr. 6 makina larëse ishte jashtë funksionit dhe teshat sipas pohimeve të drejtueses laheshin me dorë, mënyrë e cila nuk garanton higjienën maksimale. Në disa raste u konstatua se librezat shëndetësore të punonjësve ishin jashtë afatit të vlefshmërisë ndërkohë që për stafin e kuzhinës nuk respektohej rinovimi i tyre çdo 6 muaj.

Shëndeti dhe siguria e fëmijëve në kopsht dhe çerdhe realizohet mbi bazën e dy rregulloreve të miratuara nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë, “Rregullore e shërbimit shëndetësor në kopshte” dhe “Rregullore e shërbimit shëndetësor në çerdhe”. Në Tiranë shërbimi shëndetësor mbulohet nga mjekët e Operatorit Shëndetësor Vendor (OShVT) sipas një grafiku të përcaktuar, kryesisht 1 herë në javë. Gjatë verifikimit të kryer, në asnjë prej kopshteve nuk rezultonte regjistri ose kartela mjekësore që të dëshmonte punën e kryer nga mjeku, i cili sipas komunikimit që patëm duhet të ishte prezent një herë në javë sipas një grafiku të përcaktuar. Në disa prej kopshteve ai nuk ishte paraqitur për këtë vit akoma, (kopshti nr. 26) ose mjeku nuk ishte pediatër (rasti i kopshtit nr. 64 ku mjeku kishte specialitetin stomatolog), apo çerdhja nr. 4 ku mjeku mungon prej 2 vitesh, si dhe çerdhja nr. 16 dhe nr. 17, ku mjeku mungon prej 2 muajsh.

Në kopshtin nr. 36, gjatë vizitës së grupit të auditimit u konstatua prezenca e mjekut i cili, gjatë orarit që fëmijët ishin duke ngrënë vaktin e drekës, kryente peshimin e disa fëmijëve. Peshimi kryhej në afërsi të ambientit të ngrënies, i cili nuk ishte aspak i përshtatshëm. Nga intervista me mjekun rezultoi se ai nuk kishte me vete regjistrin e të dhënave të fëmijëve pasi ishte voluminoz, gjithashtu edhe kartelat e fëmijëve nuk ishin të plotësuara pasi nuk kishte të tilla në dispozicion. Kutitë e ndihmës së shpejtë në disa raste ishin të paplotësuara me medikamentet që duhet të përmbajnë.

Sa i takon detyrimeve të mjekut të QEZHEF, janë hartuar plane pune mujore dhe vjetore për mjekët e kopshteve dhe çerdheve të cilat janë të pa miratuara, e për pasojë të pazbatueshme, kjo edhe për faktin e mungesës së bashkëpunimit nga ana e OShVT, i cili gjatë ushtrimit të funksioneve të tij në kopshte dhe çerdhe nuk e përfshin mjekun e QEZHEF. Gjithashtu u konstatua se në përputhje me detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të QEZHEF, mjeku ka hartuar edhe planin e masave parandaluese që duhen marrë gjatë stinës së nxehtë, nga ku rezultoi se për vitin 2017 ky plan ishte dërguar në

kopshte dhe çerdhe më datë 08/08/2017 në përfundim të kësaj stine, ndërkohë që duhet të dërgohej në muajin maj. Plani i masave për periudhën e ftohtë rezultoi të mos jetë dërguar. Rekomandimet e dhëna në këtë plan si përdorimi i lëngjeve si çaj ose tresol, apo lëngje të freskëta, ushqime jo të konservuara etj, nuk janë plotësisht të zbatueshme pasi ato nuk janë të miratuara në menunë e ushqimit, si dhe nuk janë të konsultuara me mjekun e OSHVT. Lidhur me veprimtarinë e psikologut, në pothuajse të gjitha kopshtet e vëzhguara nuk rezultoi asnjë dosje që pasqyronte punën e tij. Mungonte regjistri i vlerësimit për çdo fëmijë, ndërkohë që u evidentuan vetëm disa plane pune vjetore apo ndonjë rast jo i plotë i identifikimit të fëmijëve autik apo me probleme të sjelljes. Raportet e monitorimit mbi zbatimin e teknikave të specialistëve psikolog, punonjës social dhe mjekut të QEZHEF duhet të realizohen nga Përgjegjësja e Sektorit të Zhvillimit dhe Kujdesit Psikosocial çdo muaj. Po kështu të dhënat statistikore për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta, mbledhen dhe përpunohen nga Përgjegjësja e Sektorit Psiko-social në statistikë 6-mujore. E gjithë procedura e sipër cituar dhe progreset dhe regreset e fëmijëve me nevoja të veçanta raportohen çdo muaj në raportet mujore të specialistit. Në të gjitha rastet e vëzhguara nga grupi i auditimit nuk rezultoi të kishte pothuajse asnjë gjurmë të punës së kryer nga psikologu në kopshtet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, me përjashtim të disa rasteve ku u konstatua prezenca e disa raporteve të përgjithshme ose planesh pune vjetore. Nuk rezultoi asnjë regjistër i vlerësimit psikosocial të fëmijëve të regjistruar në kopshte, as dosje e veçantë për fëmijë të identifikuar me çrregullime të spektrit autik ose problematika të tjera, për periudhën objekt auditimi. Nuk rezultoi asnjë plan ndërhyrje për fëmijë me nevoja të veçanta, as ndjekje e ecurisë periodike të tyre. Sipas informacionit të marrë nga ana e Përgjegjëses së Sektorit të Zhvillimit dhe Kujdesit Psikosocial, nuk ka raportim të punës së kryer nga ana e psikologëve të kopshteve për periudhën objekt auditimi. Në ndryshim me shërbimin e psikologut në kopshte, shërbimi i psikologut në çerdhet e qytetit të Tiranës është i dokumentuar pjesërisht por ka nevojë për ristrukturim. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se ekzistojnë regjistrat e vlerësimit psiko-social për çdo fëmijë, të cilët përmbajnë vlerësime nëpërmjet indikatorëve të matshëm dhe mirë përcaktuar. Gjithashtu ka edhe formate të cilat referojnë edhe nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve në tema të përzgjedhura nga psikologu. Ky raportim kryhet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e psikologut, duke lejuar në këtë mënyrë edhe ndjekjen e ecurisë së fëmijës për të matur progresin. Megjithatë formatet e përdoruar nga ana e psikologëve të çerdheve, të cilët lidhen me vlerësimin, ndjekjen, ecurinë, planet individuale, apo raportimet periodike, nuk janë të unifikuara, duke penguar krijimin e një standardi të besueshëm.

Për Bashkinë Vlorë

Referuar Rregullores së Funkcionimit të Brendshëm të Bashkisë Vlorë, Qendra Ekonomike është struktura përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të ushqimit në kopshte dhe çerdhe. Nga auditimi lidhur me këtë shërbim rezultoi se i gjithë procesi i ndjekjes së kontratave të furnizimit me produkte ushqimore, furnizimi me to, si dhe shpërndarja nëpër kopshte dhe çerdhe, nuk ishte e organizuar në bazë të një procedure të mirë përcaktuar dhe të miratuar. Furnizimi i QE kryhej çdo ditë nga furnitorët bazuar në kontratat e furnizimit me produkte ushqimore si dhe në raportimin e numrit të fëmijëve që kishin frekuentuar kopshtet dhe çerdhet. Produktet ushqimore nuk ishin të gjitha të shoqëruara me raport analiza që garantojnë cilësinë e produkteve (raport analizat ishin pjesore). Komisioni i ngritur për verifikimin e sasisë dhe përputhjen me specifikimet teknike, në përfundim hartonte një dokument të quajtur Akt Kolaudimi. Pas hartimit të

Akt Kolaudimit, kryhej hyrja në magazinë e produkteve dhe më pas shpërndarja nëpër kopshte dhe çerdhe. E gjithë praktika e ndjekur në lidhje me marrjen në dorëzim ishte jo e plotë nga ana e evidencave. Dokumentacioni shoqërues përfshirë raportet e analizave mbahej i shpërndarë duke mos lejuar në këtë mënyrë gjurmimin e veprimeve. Planifikimi i furnizimeve me ushqime për kopshte dhe çerdhe kryhej si më poshtë.

Mblidheshin kërkesat nga institucionet bazuar në forcën ditore. Kjo forcë ditore e raportuar do të shërbente për furnizimin me ushqime të këtyre institucioneve 2 ditë më pas, duke mos llogaritur ndryshimet që mund të kishte forca në ditën e furnizimit. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e grupit të auditimit rezultoi se në shumicën e kopshteve dhe çerdheve kishte luhatje të mëdha të numrit të fëmijëve nga një ditë në tjetrën (disa herë +/- 30 fëmijë). Kjo mënyrë menaxhimi si në rastin kur forca e raportuar është më e madhe ose më e vogël se ajo e ditës së furnizimit, shkakton ose cënim të gramaturës që duhet të marrë një fëmijë në bazë të menisë, ose shpërdorim të ushqimeve të gatuar. Nga verifikimi në terren i kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Vlorë rezultoi se sasia e produkteve ushqimore që furnizoheshin duhet të konsumohej e gjitha pavarësisht forcës ditore reale. Pra edhe në rastet që forca ditore ishte më e vogël se ajo e raportuar dy ditë më parë, gatuhej për një numër më të madh fëmijësh. Tepricat ushqimore hidheshin. Për sa më sipër në Bashkinë Vlorë nuk respektohej gramatura dhe kalorazhi sipas përcaktimit në menunë e miratuar. Furnizimi me produkte ushqimore nga ana e QE kryhej disa herë në ditë në varësi të produktit. Qumështi dhe buka furnizohej herët në mëngjes, më pas perimet të shoqëruara në disa raste me mishin e në raste të tjera veç. Në kopshtet dhe çerdhet e vrojtuar u konstatua se menutë e ushqimit nuk ishin të afishuara çdo ditë sipas elementëve përbërës të gatimit, por kishte një kopje të menisë javore të përgjithshme, duke cënuar në këtë mënyrë transparencën në raport me prindërit.

Në 3 çerdhet e qytetit, vakti i drekës nuk ishte gatuar me të njëjtët përbërës. Në dy raste kishte element përbërës më pak se ajo e parashikuar në menu, ose ishte ndryshuar forma e gatimit me pretendimin se nuk konsumohej nga fëmijët. Nga komunikimi verbal me punonjëset e kuzhinave u raportua se gatuhej bazuar në sasinë e produkteve që sillleshin nga QE dhe nuk kishin informacion në lidhje me gramaturat që duhet të përmbajë një porcion ushqimi. Në asnjë nga institucionet e vrojtuar punonjësit e kuzhinës nuk kishin regjistër të tepricave ushqimore, kjo për shkak të procedurës së cituar më lart. Në të gjitha rastet punonjësit e kuzhinave dhe drejtuesit nuk kishin informacion në lidhje me rregullat që duheshin ndjekur që lidhen me afishimin e menuve, ruajtjen e kampioneve, kushtet e ruajtjes së produkteve ushqimore etj. Nuk është kryer asnjë monitorim nga asnjë strukturë për të garantuar respektimin e menisë, higjienës së gatimit dhe asaj në tërësi, për shkak të mos ndarjes së përgjegjësisive. Në disa raste u konstatua se kampionët ushqimor të një dite më parë nuk ishin ruajtur (çerdhja 2, 15). Në disa kopshte vakti i pasdites qëndronte i përgatitur dhe në kushte jo të përshtatshme ruajtje që në orën 12:20. Disa prej produkteve nuk jepeshin gjatë vaktit të parashikuar, p.sh frutat qëndronin në ambientin e lojës dhe nuk jepeshin gjatë vaktit të pasdites por gjatë ditës (kopshti nr. 2).

Nga vrojtimi në terren i kopshteve dhe çerdheve, grupi i auditimit konstatoi se kushtet e higjienës ishin pjesërisht të përshtatshme. Në shumë nga kopshtet dhe çerdhet e përzgjedhura në mënyrë rastësore rezultuan probleme si më poshtë:

Në çerdhen nr. 2 u konstatuan ambiente të palyera dhe me lagështi;

Në kopshtin nr. 9 përveç kushteve higjienike jo të duhura u konstatua edhe larja e teshave brenda ambienteve të kuzhinës;

Në kopshtin nr. 10 kishte ambiente të palyera, kushte aspak higjienike dhe tualete në gjendje të mjerueshme;

Në kopshtin nr. 2 kushtet higjienike ishin aspak të përshtatshme dhe tualetet e fëmijëve jo në përputhje me standardet e higjienës. Nga lavanderia kryhej vetëm larja e peshqirëve dhe mbulesave të tavolinave ndërsa çarçafët i jepeshin prindërve për ti larë;

Në kopshtin Lef Sallata tualeti i stafit shërbente edhe për fëmijët.

Peshqirët në të gjitha institucionet e vrojtuar ishin jo të personalizuar për çdo fëmijë, në disa raste në kushte aspak të përshtatshme për tu përdorur për shkak të konsumimit të lartë.

Librezat shëndetësore të punonjësve ishin përgjithësisht të plotësuara me përjashtim të rasteve në kopshtin nr. 10 dhe çerdhen nr. 2, ku u konstatuan librezat shëndetësore jashtë afateve. Kampionet ushqimorë mbaheshin në gota plastike të hapura, jo në kushte frigoriferike ose të freskëta por në temperatura të larta.

Sa i takon shërbimit shëndetësor në kopshtet dhe çerdhet e vrojtuar rezultoi se shërbimi i mjekut dhe psikologut ishte inegzistent. Në rastin e parë nga disa edukatorë u pohua se fëmijët në rast të shqetësimeve shëndetësore dërgoheshin nga stafi i kopshteve në poliklinikat më të afërta, ndërkohë për rastin e psikologut u identifikuan vetëm disa plane pune vjetore formale ose materiale informuese.

Gjetje:

Për Bashkinë Tiranë

- ✓ Verifikimi, kontrolli dhe marrja në dorëzim e mallrave artikuj ushqimor kryhet pranë QEZHEF çdo ditë. Ky proces nuk arrin të përfundojë në orën 10.00 ashtu si parashikohet në rregulloren e procedurave për këtë qëllim.
- ✓ Produktet mish, bulmet dhe vezë mbërrijnë të parat në QEZHEF dhe qëndrojnë në pritje për rreth 3 orë deri në përfundim të gjithë procesit jo në kushte frigoriferike.
- ✓ Artikulli bizele vjen në formë të ngrirë duke qenë se nuk është gjithmonë produkt i sezonit.
- ✓ Në të gjitha rastet e peshimit të artikujve fruta perime ky proces nuk u krye nga komisioni por nga shpërndarësit e QEZHEF, të cilët tërhiqnin direkt nga mjeti i furnitorit produktet të cilët një pjesë i peshonin e një pjesë jo.
- ✓ Në kopshtin nr. 6 u konstatua mos respektim i menisë ditore.
- ✓ Në shumë raste u konstatuan teprica të mëdha të ushqimeve nga vakti. Disa nga ushqimet pjesë e menisë, si sallata me perime të ziera, tërshëra me qumësht, tërshëra me kos etj, nuk konsumoheshin plotësisht nga fëmijët.
- ✓ Në kopshtin nr. 36 ambientet e fjetjes ishin me ajër të rënduar si pasojë e higjienës jo të mirë të dyshekëve dhe lagështisë së pjesshme. Në këtë kopsht ishin lyer ambientet e përbashkëta, korridoret dhe shkallët, ndërsa në ambientet e fjetjes vihej re dukshëm mungesa e lyerjes.
- ✓ Mungojnë peshqirët e duarve të veçantë për çdo fëmijë dhe të personalizuar. Në pjesën më të madhe të rasteve ato janë tepër të konsumuar.
- ✓ Në kopshtin nr. 6 makina larëse ishte jashtë funksionit dhe teshat lahen me dorë.
- ✓ Librezat shëndetësore të punonjësve ishin jashtë afatit të vlefshmërisë ndërkohë që për stafin e kuzhinës nuk respektohej rinovimi i tyre çdo 6 muaj.
- ✓ Në asnjë prej kopshteve nuk u evidentuan regjistra apo kartela mjekësore që të dëshmonin punën e kryer nga mjeku.

- ✓ Në kopshtin nr. 36, mjeku i OSHVT kryente peshimin e fëmijëve ndërkohë që ata konsumonin vaktin e drekës. Ai nuk dispononte regjistrin e të dhënave të fëmijëve pasi ishte voluminoz, gjithashtu edhe kartelat e fëmijëve nuk ishin të plotësuara pasi nuk kishte të tilla në dispozicion.
- ✓ Mjeku i QEZHEF ka hartuar planin e masave parandaluese gjatë stinës së nxehtë për vitin 2017 më datë 08/08/2017 në përfundim të kësaj stine, ndërkohë që duhet të dërgohej në muajin maj.
- ✓ Nuk rezultoi të kishte pothuajse asnjë gjurmë të punës së kryer nga psikologu në kopshtet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, me përjashtim të disa rasteve ku u konstatua prezenca e disa raporteve të përgjithshme ose planesh pune vjetore. Nuk rezultoi asnjë regjistër i vlerësimit psiko-social të fëmijëve të regjistruar në kopshte, as dosje e veçantë për fëmijë të identifikuar me çrregullime të spektrit autik ose problematika të tjera për periudhën objekt auditimi. Nuk rezultoi asnjë plan ndërhyrje për fëmijë me nevoja të veçanta, as ndjekje e ecurisë periodike të tyre

Për Bashkinë Vlorë

- ✓ Nuk ka një procedurë të mire përcaktuar dhe miratuar të marrjes në dorëzim dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore nga ana e QE.
- ✓ Praktika e ndjekur në lidhje me marrjen në dorëzim ishte e papalotë nga ana e dokumentacionit justifikues.
- ✓ Në asnjë rast nuk zbatohet menuja ushqimore e miratuar sa i takon gramaturës dhe kalorazhit. Gatimi kryhet në të gjithë sasinë e mbërritur në kopshte dhe çerdhe dhe në fund të konsumimit shpërdorohet kur është me tepri, apo çënohet sasia e nevojshme për tu shpërndarë në një numër më të madh fëmijësh se sa ai parashikuar.
- ✓ Në kopshte dhe çerdhe nuk afishohen menutë e ushqimit.
- ✓ Kampionet ushqimore nuk ruhen në kushte të përshtatshme dhe në disa raste mungonin.
- ✓ Bashkia nuk ushtron procese monitorimi në lidhje me respektimin e menuesë, garantimin e higjienës dhe shërbimeve të tjera.
- ✓ Ka mungesë të theksuar të elementëve të higjienës në kopshte dhe çerdhe. Shumë nga këto elementë nuk janë të personalizuar dhe janë tejet të konsumuara për përdorim, si rasti i peshqirëve.
- ✓ Shërbimi i mjekut në kopshte dhe çerdhe rezulton inegzistent, ndërsa ai psiko-social është tepër formal
- ✓ Mungojnë regjistrat e vlerësimit psikosocial të fëmijëve sipas indikatorëve të përcaktuar, po kështu nuk dokumentohej identifikimi, referimi apo ndjekja e fëmijëve më probleme të spektrit autik.

Konkluzione:

Për Bashkinë Tiranë

- ✓ Procedura e verifikimit dhe marrjes në dorëzim të artikujve ushqimorë nuk është parashikuar në mënyrën më eficiente të mundshme. Ajo kryhet e nxituar për të arritur shpërndarjen e këtyre artikujve çdo ditë brenda ditës në të gjithë kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, duke mbartur riskun e mos verifikimit të plotë dhe të detajuar të cilësisë dhe sasisë së artikujve. Për pasojë cilësia e këtij shërbimi çënohej nga pritja e gjatë e artikujve në kushte të papërshtatshme, mos verifikimi i detajuar i ambalazhimeve, apo dokumenteve certifikuese etj.

- ✓ Produktet ushqimore të menisë së ofruar, nuk janë plotësisht në përputhje me shijet e fëmijëve. Mos konsumimi i disa prej artikujve ushqimorë në raste të përsëritura, nuk është marrë në analizë nga QEZHEF së bashku me specialistë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për modifikime të nevojshme.
- ✓ Megjithëse kushtet higjieno-sanitare paraqiten pozitive, ka ende raste sporadike të cilat kanë nevojë për përmirësim, të tilla si zëvendësimi apo personalizimi i produkteve të higjienës personale, apo dhe nevoja për investime në ambiente dhe orendi për të garantuar efektivitetin e këtij shërbimi.
- ✓ Shërbimi shëndetësor dhe ai psiko-social nuk janë aspak në nivelin e duhur dhe kanë nevojë për rikonceptim të mëtejshëm. Kryesisht në kopshte, ky shërbim është ende në nivele formale dhe nuk garanton rezultatet për të cilat funksionon.

Për Bashkinë Vlorë

- ✓ Nuk është garantuar një shërbim efektiv ushqimor dhe shëndetësor.
- ✓ Procesi i planifikimit dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore nga ana e QE është jo eficient dhe nuk garanton respektimin e menisë së miratuar.
- ✓ Në tërësi stafi përgjegjës për administrimin dhe ofrimin e shërbimit në kopshte dhe çerdhe nuk ka njohuri të mjaftueshme të akteve normative që orientojnë garantimin e këtij shërbimi, duke cënuar eficiencën e shërbimit.
- ✓ Mungesa e strukturave të posatshme përgjegjëse për administrimin e kopshteve dhe çerdheve, si dhe mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit mes Bashkisë, DAR rajonal dhe OShV Vlorë ka sjellë si pasojë një shërbim mjekësor dhe psiko-social inegzistent.

Rekomandime:

- ✓ QEZHEF nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të marrë masa për përcaktimin e një grafiku me orare të veçanta të mbërritjes së furnizimeve me artikuj ushqimorë, duke përcaktuar mbërritjen e produkteve të mishit vezëve dhe bulmetit të fundit në radhë, për të eliminuar pritjen e tyre me orë dhe në kushte jo gjithmonë frigoriferike.

Menjëherë

- ✓ Bashkia Tiranë dhe QEZHEF dhe Bashkia Vlorë, të hartojnë një axhendë takimesh mes tyre dhe strukturave që mbulojnë shërbimin e mjekut dhe psikologut, e cila të finalizohet me një marrëveshje bashkëpunimi mes institucioneve ku të përcaktohen përgjegjësitë konkrete dhe detyrimet e ndërsjellëta për të garantuar një shërbim real dhe jo fiktiv në këto institucione.

Brenda 6 mujorit 2020

- ✓ Bashkia Tiranë nëpërmjet DPN3 dhe Bashkia Vlorë nëpërmjet Qendrës Ekonomike, të marrin masa për zëvendësimin e të gjitha elementeve të higjienës personale të fëmijëve tejet të amortizuara, si dhe ofrimin e menjëhershëm të shërbimeve bazike të mirëmbajtjes sapo ato konstatohen (sipas gjetjeve të listuara më lart).

Menjëherë

- ✓ Bashkia Tiranë dhe QEZHEF të zhvillojnë konsultime me specialist të MSHMS për analizimin e situatës së mos konsumimit të disa prej produkteve ushqimore në kopshte dhe çerdhe, si dhe mundësinë e modifikimeve të nevojshme të menisë

ushqimore. Në këtë kontekst të diskutohet gjithashtu, mundësia e eliminimit të produkteve të cilat nuk janë të stinës dhe që aktualisht konsumohen të ngrira.

Brenda mujorit 2020

- ✓ QEZHEF nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Administrimit dhe Bashkia Vlorë nëpërmjet Qendrës Ekonomike, të vlerësojnë mundësinë e furnizimit të kopshteve dhe çerdheve me produktet ushqimore 1 herë në javë, duke ju referuar forcës së përlllogaritur si një mesatare javore, për të shmangur disbalancat e krijuara nga ndryshimi i forcës ditore në rastin e Bashkisë Vlorë dhe eliminimin e risqeve të sipër përmendura që vijnë nga rastet e kthimeve të produkteve, apo procedurës së përshpejtuar të marrjes në dorëzim të artikujve ushqimor në rastin e QEZHEF.

Brenda vitit 2020

- ✓ Qendra Ekonomike pranë Bashkisë Vlorë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të planifikimit dhe marrjes në dorëzim të produkteve ushqimore, si dhe të garantojë mbajtjen e rregullt të dokumentacionit që i bashkëlidhet praktikës së marrjes në dorëzim të tyre, përfshirë raportet e analizave të çdo produkti. Për këtë qëllim mund të përdoret si praktikë e mirë dokumenti i hartuar nga QEZHEF për këtë qëllim.

Brenda 6 mujorit 2020

- ✓ Bashkia Vlorë të marrë masa për ngritjen e grupeve të monitorimit me fokus respektimin e menisë ushqimore dhe cilësisë së gatimit si dhe kushteve të higjienës, si dhe të hartojë plane veprimi për zgjidhjen e situatës nga gjetjet që do të konstatohen.

Menjëherë

3.2.2 A ofrojnë mjediset e jashtme dhe të brendshme kushtet optimale për mirërritjen e fëmijëve?

Një aspekt të rëndësishëm në garantimin e një shërbimi parashkollor sa më efektiv, përbën edhe përmbushja e standardeve sa i takon infrastrukturës së përgjithshme të godinave, hapësirave të nevojshme, si dhe garantimit të elementeve të sigurisë në këto ambiente. Mjediset brenda dhe jashtë institucioneve parashkollore, përshpejtojnë rritjen dhe zhvillimin optimal përmes mundësive që u krijon fëmijëve për të mësuar, luajtur dhe për tu zhvilluar. Cilësia e hapësirave fizike dhe kapaciteteve ndikon në nivelin e përfshirjes së fëmijëve dhe në cilësinë e bashkëveprimit midis të rriturve dhe fëmijëve. Standardet që duhen respektuar në funksion të garantimit të mjediseve të brendshme dhe të jashtme sa më bashkëkohore përcaktohen në Rregulloren Higjiëno-Sanitare nr. 105, dt. 17.05.1995, në VKM nr. 159, datë 01.03.2017 “Për ndërtimin dhe funksionimin e kopshteve” dhe VKM nr. 530, datë 20.07.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve. Sa i takon hapësirave të brendshme, sipas standardeve, duhet të parashikohet një sipërfaqe e brendshme minimale prej 1,5m² dhe optimale 2,5-3 m²/fëmijë. Principi bazë i planifikimit të ndërtimit të një kopshti, është izolimi në grupe. Çdo grup do të ketë nga 15 fëmijë deri në një maksimum prej 30 fëmijë. Ndarja e fëmijëve në grupe bëhet në bazë të grup moshave. I gjithë kompleksi të përbëhet nga 70-75 fëmijë. Rekomandohet që godina të mos projektohet për më shumë se 125 fëmijë. Për sa më lart, nga auditimi rezultoi se në shumë pak raste këto standarde mund të respektohen. Vitet e fundit është vënë re një

angazhim i lartë nga institucionet vendore për përmirësimin e kushteve fizike që lidhen me godinat, pajisjet, orendi e mjetet didaktike, por sërish vërehet se infrastruktura fizike nuk i përgjigjet në të gjithë shtrirjen e saj kërkesave bashkëkohore sipas standardeve qartazi të përcaktuara në VKM e sipër përmendura. Gjatë këtyre viteve, përpjekjet janë përqendruar kryesisht në rikonstruksionin e godinave, ndërkohë që nevoja më imediate është shtimi i atyre të reja. Krahas mos respektimit të kapacitetit maksimal prej 125 fëmijë, vihet re edhe cënimi i raportit edukator/fëmijë²⁰, fenomen shumë më i theksuar në rastin e kopshteve, ndërkohë që për vitin 2018 ky raport ka një përmirësim të ndjeshëm sa i takon çerdheve, si pasojë e uljes së konsiderueshme të frekuentimit të tyre.

Përmasat e grupit	6	8	10	12	14	16	18	20
Moshë e fëmijëve								
Bebe (3 muaj)	1:3	1:4						
Motakët (12-24 muaj)	1:3	1:4	1:4	1:4				
2 vjeç (24-30 muaj)		1:4	1:5	1:6				
2.5 vjeç (30-36 muaj)			1:5	1:6	1:7			
3 vjeç					1:7	1:8	1:9	1:10

Burimi: Standardet e Projektimit të Çerdheve

Lëvizjet demografike vitet e fundit kanë sjellë një rritje të nevojave për shtimin e ambienteve në çerdhe dhe kopshteve apo të këtyre godinave. Probleme të mëdha u vunë re dhe në mbipopullimin e grupeve të veçanta ku numri i fëmijëve e tejkalon numrin e përcaktuar në standarde për një zhvillim sa më normal dhe efikas të këtij shërbimi. Po kështu, si pasojë e mungesë së këtyre hapësirave, shpesh grupet nuk kishin përbërje homogjene, duke cënuar dhe krijuar konfuzion në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ditore sipas programeve përkatëse. Bashkia Tiranë nuk ka arritur ti përgjigjet me të njëjtin hap zgjerimit urbanistik që po i ndodh qytetit, duke bërë që nevojat për shtimin e këtyre ambienteve të jenë shumë të larta se ajo çka ofrohet aktualisht. Kjo edhe si pasojë e neglizhencës së këtij institucioni, pasi referuar Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, ky institucion ka parashikuar ndërtimin e 8 çerdheve dhe 7 kopshteve të reja nëpërmjet PPP, inkorporimin e disa kopshteve brenda godinave të shkollave 9-vjeçare, si dhe ndërhyrjet e nevojshme infrastrukturore në 2 çerdhe dhe 11 kopshte ekzistuese²¹ deri në vitin 2020. Deri më tani, shumë afër përfundimit të afatit të kësaj strategjie, këto objektiva janë larg përmbushjes së tyre. Për periudhën objekt auditimi 2017-2018, rezulton se janë ndërtuar vetëm 2 çerdhe dhe 1 kopsht. Realizimi i këtyre objektivave do ju vinte në ndihmë zonave të ndryshme të Tiranës, të cilat hasin në probleme të mbipopullimit dhe zgjedhjes për dërgimin e fëmijëve në kopshte apo çerdhe jopublike. Kjo zgjedhje e banorëve të Tiranës duhet konsideruar dhe si një domosdoshmëri për tu dhënë zgjidhje problematikave që hasen gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve si pasojë e kërkesave të larta për frekuentim duke krahasuar me potencialin e vakët që Bashkia Tiranë ofron. Si pasojë e këtij mbipopullimi cënohen edhe standarde të tjera që lidhen me hapësirat, si p.sh në dhomat e gjumit gjenden krevate ngjitur me njëri tjetrin, pa

²⁰ Aneksi bashkëlidhur këtij projekt raporti

²¹ Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, Tabela nr. 30

respektuar hapësirën prej 0.5 m largësi. Bashkia Tiranë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme nr. 3, ka përgjegjësinë për mirë administrimin e çdo çështje që lidhet me realizimin e investimeve në kohë dhe me cilësi në kopshtet dhe çerdhet, duke siguruar përmirësimin e infrastrukturës të këtyre ndërtesave dhe kushteve të mësimdhënies. Referuar intervistave në terren grupi i auditimit konstaton se DPN3 nuk merr në konsideratë të gjitha kërkesat që ju vinë nga drejtuesit e kopshteve dhe çerdheve, duke krijuar hendeqe në zgjidhjen e problematikave ditore dhe në vazhdimësinë e një procesi normal për mirë rritjen e fëmijëve. Nga ana tjetër vihet re një indiferentizëm total nga ana e Bashkisë Vlorë, pavarësisht kërkesave nga specialistët përkatës nëpërmjet shkresave për shtim fondi dhe nevoja në ndërhyrje për investime. Godinat e çerdheve në Bashkinë Vlorë janë totalisht jashtë çdo standardi. Godinat ndodhen në territore ku vështirësia për akses të fëmijëve është e pazakontë, ku me gjithë vështirësitë e kushteve aspak të përshtatshme, si lagështi e theksuar, pellgje uji në hyrje, shkallë hekuri të improvizuara në anën e jashtme të ndërtesës, vendodhja e çerdhes në rrugicë dhe me trotuare që vështirëson kalimin e karrocave, fëmijët duhet të ndajnë ambientet e godinës pronë të Bashkisë me institucione të tjera jashtë fokusit të shërbimit parashkollor.



Bashkia Vlorë

Në të dyja qytetet, u vu re gjithashtu prania e portativëve për vaktin e gjumit, të cilat përbëjnë një shqetësim madhor për shëndetin fizik të fëmijës. Theksojmë në këtë rast se fjetja në kushte të pa përshtatshme dhe dëmet në formimin fizik gjatë kësaj moshe janë të pariparueshme. Po kështu, në të dy rastet u konstatua se si pasojë e mungesës së hapësirave të nevojshme, i njëjti ambient shërbente edhe për aktivitetet ditore dhe në përfundim të tyre ngriheshin tavolinat dhe shtroheshin portativët për fjetjen.



Bashkia Vlorë



Bashkia Tiranë

Masivisht u vu re gjithashtu mungesa e dhomave të veçanta të mjekut, psikologut dhe të izolimit në rast sëmundje të fëmijës, në kundërshtim me standardet e sipërpërmendura. Në këto ambiente një element kyç janë dhe normat e sigurisë ndaj zjarrit apo formave të tjera. Vendosija e kamerave është një nga kërkesat kryesore të vendosura në standarde për sigurimin dhe ruajtjen e fëmijëve nga çdo formë abuzimi apo rreziku të mundshëm, gjë që nuk u konstatua në asnjë nga kopshtet dhe çerdhet e vizituara në të dy qytetet. Gjithashtu ka mangësi të sistemit për njoftimin e rrjedhjeve të gazit për arsye se kuzhinat punojnë me gaze dhe bombulat e gazit janë të ekspozuara në ambientet e kuzhinës. Në disa prej tualeteve të kopshteve u konstatuan detergjente për pastrim, lehtësisht të arritshëm nga fëmijët. Po kështu në disa raste u konstatuan se ambientet e qëndrimit të fëmijëve kishin akses në ballkone të cilat ishin jo sipas standardeve të sigurisë.



*Peshqirë tepër të konsumuar dhe
detergjentë lehtësisht të kapsbëm nga fëmijët*



Tualete jashtë standardeve



Bombula e gazit në brendësi të ambienteve

Sa i takon mjediseve të jashtme ato duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme të përdorshme, ku t'iu krijohet mundësi fëmijëve të përdorin lojërat në natyrë për çdo grup moshë. Në këtë mjedis duhet të respektohet patjetër balanca diell-hije-gjelbërim në mënyrë që të përdoret si për aktivitetet ditore ashtu edhe për bashkëveprimet sociale. Nga vizitat në terren u konstatua se lodrat në ambientet e jashtme dhe të brendshme nuk ishin të përshtatshme dhe komfort standardeve. Disa godina në ambientet e jashtme të tyre kanë stola të vjetër ose mangësi të tyre si dhe të tendave të diellit për mbrojtjen e fëmijëve nga efektet natyrore (diell, shi, erë);



Bashkia Vlorë



Bashkia Tiranë

Gjetje:

- ✓ Në pjesën më të madhe të rasteve mbipopullimi në kopshte dhe çerdhe ka çenuar jo vetëm standardet e hapësirave por edhe atë edukator/fëmijë.
- ✓ Objektivi strategjik i Bashkisë Tiranë, për vënien në zbatim të mundësisë për inkorporimin e disa kopshteve brenda godinave të shkollave 9-vjeçare, nuk është realizuar;
- ✓ Objektivi strategjik i Bashkisë Tiranë, për përmirësimin e cilësisë dhe garantimin e objekteve të reja dhe sipas standardeve në funksionim të shërbimit parashkollor nëpërmjet PPP, nuk është realizuar;
- ✓ DPN3 shfaq vonesa apo neglizhencë në përmbushjen e nevojave për ndërhyrje në infrastrukturën e brendshme dhe të jashtme në çerdhe dhe kopshte. Në shumë raste, procedura të mirëmbajtjes për orendi të ndryshme financohen nga prindët;
- ✓ Në Bashkinë Vlorë, nuk ka asnjë sektor/drejtori të profilizuar dhe përgjegjës lidhur me shërbimin parashkollor dhe as objektiva strategjike për zhvillimin e këtij shërbimi;
- ✓ Bashkia Vlorë nuk i përgjigjet nevojave elementare infrastrukturore në kopshte dhe çerdhe. Vakti i gjumit kryhej në dysheqe në tokë apo në portative dhe në një rast edhe në ballkonin e modifikuar me vetratë të kopshtit;
- ✓ Ambientet e brendshme nuk sigurojnë hapësirat e domosdoshme si: zyra e mjekut, psikologut, shërbimit social, ambientet e zonës aktive, ngrënies dhe fjetjes. Tualetet në disa kopshte/çerdhe nuk plotësonin kushtet minimale;
- ✓ Nëpër kopshte/çerdhe nuk ka të instaluar kamera sigurie dhe as sistemi i mbrojtjes nga zjarri apo elementët e sigurisë në rast emergjencash. Po kështu mungojnë sistemet për njoftimin e rrjedhjeve të gazit;
- ✓ Në të gjitha rastet u konstatua përdorimi i makinave larëse jo profesionale me kapacitet të ulët (përdorim familjar), ndërkohë që numri i fëmijëve që frekuentojnë çdo kopsht është shumë i lartë, mesatarisht 200 fëmijë;
- ✓ Lodrat në ambientet e jashtme dhe të brendshme nuk ishin të përshtatshme dhe komfort standardeve. Disa godina në ambientet e jashtme të tyre kanë stola të vjetër, ose mangësi të tyre si dhe të tendave të diellit për mbrojtjen e fëmijëve nga efektet natyrore (diell, shi, erë);

- ✓ Në pjesën më të madhe të kopshteve/çerdheve të vizituara ambienteve të brendshme u sigurohet sistemi ngrohjes, por kanë mangësi në sistemin e ftohjes gjatë stinës së nxehtë.

Konkluzione:

- ✓ Rritja e urbanizimit gjatë këtyre viteve, nuk është shoqëruar me përmirësimin progresiv të infrastrukturës së shërbimit parashkollor dhe si pasojë gjendja e kopshteve dhe çerdheve rezulton e mbipopulluar gjë që ka sjellë çënimin e pjesës më të madhe të standardeve sa i takon hapësirave në ambientet e jashtme, të brendshme, të fjetjes, etj dhe të efektivitetit në tërësi
- ✓ Mungesa e një sektori/drejtorie të posatshme për administrimin e kopshteve dhe çerdheve në Bashkinë Vlorë bën të pamundur përmbushjen me efektivitet të detyrimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore për garantimin e nevojave të investimeve apo rikonstruksioneve të godinave;
- ✓ Të dy Bashkitë nuk kanë arritur të garantojnë përmbushjen me efektivitet të standardeve lidhur me kushtet e sigurisë, ambientet shlodhëse, si dhe orendive dhe mjeteve didaktike të nevojshme.

Rekomandime:

- ✓ Duke synuar një zgjidhje afatgjatë për infrastrukturën e munguar të shërbimit parashkollor, Bashkia Tiranë dhe Vlorë në bashkëpunim me Shoqatën e Ndërtuesve të vlerësojnë mundësinë e lehtësirave fiskale apo mekanizmave të tjerë nxitës në rastet kur gjatë ndërtimeve të reja, këta ndërtues garantojnë hapësira sado të vogla në katet e para për integrimin e kopshteve dhe çerdheve të reja;

Brenda vitit 2020

- ✓ Bashkia Tiranë, Bashkia Vlorë dhe QEZHEF të intensifikojnë përpjekjet për vendosjen e kontakteve të vazhdueshme me OJF apo donatorë të huaj për mundësimin e pajisjeve apo orendive të cilat trajtuar më lart rezultojnë jashtë standardeve, në funksion të garantimit të një shërbimi ditor sa më efektiv në kopshte dhe çerdheve.

Në vazhdim

- ✓ Bashkia Tiranë dhe Vlorë nëpërmjet sektorëve të Buxhetit, të marrin në studim mundësinë e rialokimit të buxhetit apo shtimin e fondeve në dispozicion të investimeve në kopshte e çerdhe për të garantuar minimalisht nevojat elementare të këtyre institucioneve si sistemi i ftohjes në stinën e nxehtë, lodrat e përshtatshme në ambientet e jashtme dhe të brendshme, zëvendësimin e produkteve të higjienës personale, etj, elementë të cilët aktualisht po garantohen nga kontributet e prindërve.

Menjëherë

3.3 Trajtimi i observacioneve

Pas dërgimit të projekt raportit të auditimit në subjektet përkatëse, QEZHEF ka rrespektuar afatin për dërgimin e observacioneve të cilat kanë mbërritur në KLSH me shkresën nr. 424/11, datë 19.12.2019. Për sa më lart, si dhe pas realizimit të takimit ballafaques me QEZHEF, sqarojmë si më poshtë:

Lidhur me observacionin mbi pikën 1.4.1 të projekt raportit mbi numrin e çerdheve dhe kopshteve, sqarojmë se, duke qenë pjesë e programit, kjo rubrikë është hartuar që në fazën studimore dhe grupi i auditimit i është referuar të dhënave që QEZHEF ka të publikuara në faqen zyrtare. Megjithatë do të bëhet korigjimi i nevojshëm, ndërkohë të përditësohet faqja e ëeb e QEZHEF.

Lidhur me komentin mbi pikën 1.4.2 “Politikat e institucionit” ku subjekti shprehet se QEZHEF zbaton politika dhe strategji dhe jo harton, sqarojmë se në këtë paragraf nuk është thënë QEZHEF nuk ka hartuar strategji, por në mungesë të objektivave strategjike (përgjegjësi e Bashkisë Tiranë), QEZHEF e mbështet punën në objektiva vjetore të hartuara prej saj. Theksojmë faktin se mungojnë objektivat strategjike në tërësi, nuk është e thënë që strategjia e zhvillimit të jetë personale e QEZHEF, por sqarojmë se është e nevojshme ekzistenca e një dokumenti politikash në tërësi për administrimin e çerdheve dhe kopshteve, e cila mungon.

Lidhur me komentin mbi pikën 1.4.3 “Pesha në Buxhet” ku subjekti parashtron arsyen e mos realizimit të investimeve, sqarojmë se, grupi i auditimit është bazuar në dokumentacionin e rakorduar me thesarin e vënë në dispozicion nga sektori i financës për vitin 2017, në të cilin realizimi i investimeve rezulton zero. Megjithatë do të shtohet në raport sqarimi i dhënë nga subjekti mbi çështjen e vonesës së pagesave. Sa i takon vlerës së përdorimit faktik të fondeve për vitin 2018, pas vënies në dispozicion të evidencave vërtetuese, grupi i auditimit do të pasqyrojë vlerat e saktësuara.

Lidhur me komentet mbi pikën 4 “Mesazhi i auditimit”, i cili nga subjekti cilësohet i papërshtatshëm dhe ku renditet puna e bërë nga Bashkia Tiranë që në fillim të mandatit, sqarojmë se në raportet e mëparshme të auditimeve të performancës të kryer në vitet 2014 dhe 2015, është vlerësuar edhe veprimtaria dhe arritjet pozitive në atë periudhë, megjithatë kjo nuk nënkupton se puna ka mbaruar dhe shërbimi aktualisht është optimal dhe nuk ka nevojë për përmirësime, kjo edhe për faktin se gjatë inspektimeve në terren standardet e përmendura rezultuan të cënuara dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme. Konkretisht për pikat e listuara në observacion sqarojmë se, pavarësisht komentit tuaj se është rinovuar baza e materialeve të imta (peshqirë, çarçafë etj), në terren rezultoi se peshqirët ishin tej mase të konsumuar dhe të vjetëruar. Lidhur me mjetet didaktike dhe lodrat, në të gjithë institucionet e vizituara nga grupi i auditimit u konstatua se për artikujt e sipër përmendur kërkohej plotësimi i nevojave nga prindërit dhe për pasojë pjesa më e madhe e lodrave ishin jashtë standardeve të parashikuara (pellush apo plastike). Sa i takon raportit edukator/fëmijë ku shpreheni se standardi nuk është cënuar, sqarojmë se nga konstatimet në terren rezultoi se grupet e fëmijëve përveçse ishin të mbi populluar (përgjithësisht mbi 30 fëmijë), në çdo rast kishin në dispozicion vetëm 2 edukatore/grup dhe një ndihmëse (megjithëse kjo e fundit nuk garanton standardin). Së dyti lidhur me pretendimin se raporti edukator/fëmijë llogaritet mbi numrin e fëmijëve që frekuentojnë dhe jo të atyre të regjistruar, sqarojmë se në opinionin e grupit të auditimit parashikimet apo përlllogaritjet kryhen mbi të dhëna të qëndrueshme dhe jo variabël, pra mbi numrin e fëmijëve që keni pranuar të regjistroni dhe ofroni shërbim. QEZHEF nuk ka të drejtë të paragjykojë frekuentimin e fëmijëve. Duke llogaritur në këtë mënyrë raportin edukator/fëmijë edhe standardi kthehet në variabël dhe në rast të ndonjë frekuentimi të jashtëzakonshëm nga të gjithë të regjistruarit, kopshti/çerdhja do të kthehej në kaos. Gjatë

vizitave në terren u konstatua se në një marrëveshje të heshtur me prindërit, për mungesë të kapaciteteve(krevateve) prindërit jo të punësuar i merrnin fëmijët nga kopshti/çerdhja para orarit të fjetjes. Së fundmi, “argumentimi” se rritja e numrit të kërkesave për regjistrim nënkupton rritjen e cilësisë së shërbimit, sqarojmë se ky arsyetim është totalisht i pa bazuar, pasi nuk u konstatua asnjë studim apo analizim i shkaqeve të rritjes së kërkesave, të cilat mund të jenë psh, rritja e popullsisë, lëvizjet demografike, kosto e papërballueshme të shërbimit në privat, etj. Ashtu sikurse u diskutua dhe gjatë takimit ballafaques edhe në rastet ku një pjesë e fëmijëve nuk frekuentojnë për një kohë të gjatë kopshtin/çerdhen, QEZHEF rikuperon këto vende duke bërë regjistrime të tjera, pra duke u kthyer pothuaj në gjendjen e mëparshme. Nga diskutimi gjatë ballafaqimit me subjektin u ra dakord të modifikohet mesazhi i auditimit sa i takon shërbimit mjekësor dhe psiko-social të ofruar për çerdhet e Tiranës.

Lidhur me pikën 5 të observacioneve për mungesën e një dokumenti me prioritet strategjike, grupi i auditimit i referohet Bashkisë Tiranë dhe në asnjë rast në këtë gjetje nuk është ngarkuar me përgjegjësi QEZHEF për mos hartimin e këtij dokumenti. Ndërkohë për rastin e përditësimit me kuadrin rregullator të BE, sqarojmë se në një auditim përputhshmërie mund të qëndronte arsyetimi se QEZHEF nuk kryen asnjë veprim jashtë atyre të parashikuara në rregullore, ndërkohë nga këndvështrimi i performancës gjykojmë se marrja e iniciativave sikur edhe vetëm lobuese në funksion të përmirësimit të shërbimit apo kuadrin rregullator, nuk përbën shkelje të rregullores.

Lidhur me pikën 6 të observacioneve ku pretendohet se objektivat e QEZHEF janë të matshme dhe të përcaktuara qartë, apo me struktura përgjegjëse të identifikuara, sqarojmë se në dokumentet e analizave vjetore të vëna në dispozicion rezulton se objektivat parësore janë tepër të përgjithshëm dhe pasohen nga nën-objektiva të cilët nuk janë të tillë. “Të vlerësohet.....” nuk përbën një objektiv dhe aq më tepër konkret e të matshëm, ashtu sikurse janë shumica e nën-objektivave në këtë dokument. Të ndërtohen çerdhe dhe kopshte përveçse nuk është objektiv që arrihet dhe as ndikohet nga QEZHEF, nuk evidentohet as elementi matës i këtij objektivi, siç pretendohet. Sa kopshte dhe çerdhe do të ndërtojë QEZHEF në vitin pasardhës?

Lidhur me pikën 7 të observacioneve mbi mangësitë në bashkëpunim dhe shkëmbim informacionesh me njësitë e tjera monitoruese për këtë shërbim, sqarojmë se gjetja mund të jetë keqkuptuar, pasi në pjesën shtjelluese të projekt raportit është sqaruar qartë që kjo mangësi i takon organeve të sipër përmendura inspektuese dhe monitoruese, pra është një mungesë e vullnetit të tyre për bashkëpunim. Për këtë arsye grupi i auditimit ka rekomanduar hartimin e protokolleve të bashkëpunimit për rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë në kryerjen me seriozitet të këtij shërbimi nga organet e sipër përmendura.

Lidhur me pikën 8 të observacioneve mbi përdorimin e standardeve tepër të vjetëruara dhe faktin se vjetërsia e tyre nuk impakton punën e QEZHEF, ftojme subjektin të konsultojë me kujdes pjesën shtjelluese në projekt raport lidhur me këtë gjetje, pasi ndër të tjera një nga shembujt e shkeljes së rregullores higjieno-sanitare të shekullit të kaluar (vitit 1995) nga QEZHEF, është përdorimi i gazit në ambjentet e kopshteve/çerdheve i cili në këtë rregullore është i ndaluar.

Lidhur me pikën 9 të observacioneve mbi mungesën e standardeve të zhvillimit, përkujdesjes dhe mirërritjes së fëmijëve dhe programet e prindërimit pozitiv, si dhe faktit se kjo përgjegjësi nuk është e QEZHEF, sqarojmë se QEZHEF nuk i është lënë asnjë rekomandim për hartimin e këtij standardi, por përsëri në këndvështrimin e performancës dhe në rolin e garantuesve kryesor të zhvillimit dhe mirërritjes së fëmijëve duhet të jetë lobues dhe të ngrejë zërin kur këto të drejta nuk po garantohen. Referuar Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, Bashkitë dhe QEZHEF mund të mos jenë miratuesit përfundimtarë të këtyre dokumenteve, por siç e keni shprehur dhe vetë, janë organet kryesore pjesëmarrëse në grupet e punës për hartimin dhe konsultimin e tyre.

Lidhur me pikën 10 të observacionit mbi përgjegjësinë e ndërtimit apo rikonstruktimit të godinave, të cilat QEZHEF i konsideron një objektivi të saj, sqarojmë se, ashtu sikurse u diskutua dhe në ballafaqim, detyrimi i QEZHEF është vetëm vlerësimi apo evidentimi dhe paraqitja rregullisht pranë DPN3 (njësia kryesore përgjegjëse për sigurimin e kapaciteteve infrastrukturore për kopshtet dhe çerdhet panë Bashkisë) e kërkesave, problematikave, apo nevojave për ndërhyrje në godina dhe infrastrukturë. Reagimi ose jo i kësaj njësie pranë Bashkisë nuk numërohet si objektivi i pa plotësuar nga QEZHEF, por nga Bashkia Tiranë. Në dokumentet e sipër përmendura nuk është e qartë se në çfarë mënyre e arrin QEZHEF objektivin e investimeve apo ngritjeve të godinave pasi nuk ka kapacitetet dhe detyrimin për këtë çështje.

Lidhur me pikën 11 dhe 12 të observacioneve mbi të drejtën e QEZHEF për ndërhyrjen në menunë ushqimore, sqarojmë se QEZHEF në pjesën e parë të observacionit ka pohuar vetë se roli i saj në menunë ushqimore mund të lidhet me konsultimet me specilaistë nutricionistë, si dhe mbledhjen sugjerimeve të prindërve për konsumimin e ushqimit, por në fund struktura përgjegjëse për vlerësimin e nevojës së modifikimeve në menu dhe kalorazh, apo hartimin e një menuje të ndryshuar, është vetëm e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. QEZHEF nuk mund të vendosë të mirëqenë një objektivi për ndryshimin e menusë për vitin pasardhës, kur hartimi dhe miratimi i kësaj menuje varet nga një strukturë tjetër. Objektivi i QEZHEF mund të jetë rritja e numrit të monitorimeve dhe hartimi i një studimi mbi konsumimin e ushqimeve apo nivelin e pëlqyeshmërisë nga fëmijët, për tja përcjell më tej këto analiza strukturave përgjegjëse për ndërhyrjet në menu. Pra, lidhur me fjalinë në observacion se QEZHEF ka vepruar në kompetencë të plotë për ndryshimin e menusë, theksojmë përsëri se në rast se MSHMS nuk do gjykonte të nevojshme miratimin e ndryshimeve në menu, QEZHEF ka detyrimin të zbatojë me rigorozitet menunë e mëparshme dhe të mos devijojë në asnjë element apo sasi të saj edhe nëse e konsideron të arsyeshme. Ndërkohë grupi i auditimit i qendron përsëri rekomandimit për hartimin e menusë alternative për fëmijët alergjikë ose që shfaqin rezistencë në konsumimin e një ushqimi të caktuar, pasi menuja e miratuar është shumë strikte. Ajo nuk parashikon alternativa zëvendësuese dhe kjo përzgjedhje nuk mund të lihet në dorën apo gjykimin subjektiv dhe të pa unifikuar të kuzhinieres apo edukatores. Së fundmi theksojmë se në terren, grupi i auditimit vuri re në shumë kopshte mos konsumimin e perimeve të ziera në masë dhe jo nga një numër i vogël fëmijësh, po kështu konstatime të konfirmuara edhe në monitorimet e kryera nga QEZHEF. Në lidhje me pretendimin se mjeku i QEZHEF orienton kuzhinën për përgatitjen e vaktit për fëmijët që janë alergjik, sqarojmë se nuk rezultoi asnjë rast i dokumentuar ku mjeku i QEZHEF të orientonte menu specifike, ndërkohë që në vizitat në terren u konstatuan fëmijë me alergji apo intolerancë ushqimore. Së fundmi, lidhur me ruajtjen e kampionëve ushqimorë, sqarojmë se

gjetja i referohet dublimeve apo paqartësive që hasen në rregullore të ndryshme për këtë çështje dhe nuk është përmendur në asnjë rast se QEZHEF ruan në kushte të papërshtatshme këto kampionë. Pra konstatimi lidhet me nevojën e theksuar disa herë për përditësimin e standardeve.

Lidhur me pikën 13 të observacioneve mbi procedurën e pritjes së produkteve ushqimore, sqarojmë se të gjitha gjetjet dhe konstatimet e pasqyruara në projekt raport janë raste të evidentuara qartazi gjatë inspektimit të grupit të auditimit. Në datën 23.10.2019 grupi i auditimit ka qenë prezent gjatë të gjithë procedurës së pranimit të ushqimeve, pothuaj deri në përfundim të kësaj procedure dhe ka konstatuar të gjitha rastet e përmendura në material. “Procesi i kontrollit kryhet me profesionalizëm.....” është një shprehje klishe që nuk i përshtatet fare rastit në fjalë, pasi observacioni nuk shoqërohet as me ndonjë fakt apo provë që të rrëzojë atë çfarë është parë nga grupi i auditimit. Së fundmi, lidhur me kohën e pritjes së produkteve mish dhe bulmet prej orësh në automjetet e hapura, përmendim faktin se në periudhën e kryerjes së vizitës temperaturat kanë qenë mbi 25°C, pra pretendimi se lëvrimi bëhet sipas motit nuk qendron.

Lidhur me pikën 15 të observacioneve mbi pa mundësinë e QEZHEF për të furnizuar kopshtet dhe çerdhet me bazë javore dhe jo ditore, sqarojmë se nëse vlerësohet se nga dita në ditë disbalancat janë minimale, rrjedhimisht edhe mesatarja nga java në javë me deduksion nuk mund të jetë e ndryshme. Së dyti, ashtu sikurse u diskutua në ballafaqim, rekomandimi është lënë të vlerësohet nga QEZHEF, çka do të thotë se në rast se QEZHEF harton një zgjidhje më të mirë për këtë proces, por që do të eliminonte risqet e përmendura në trajtimin e materialit, veprimet e ndërmarra janë më se të mirëpritura.

3.4 Përmbledhje

Ky raport auditimi, ashtu siç vihet re edhe nga piramida e pyetjeve, është konceptuar ta vlerësojë performancën e shërbimit në kopshte dhe çerdhe në dy drejtime, atë të mbështetjes nga kuadri rregullator dhe atë të plotësimit të objektivave konkrete në ofrimin e një shërbimi të tillë. Sa i takon drejtimit të parë, vlerësim i cili lidhet me plotësinë dhe qartësinë e të gjithë akteve ligjore e normative në fuqi, apo nivelit të prioritetit që i është dhënë këtij shërbimi në qytete e marra në shqyrtim Tiranë dhe Vlorë me objektiva strategjike konkrete, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se asnjë nga Bashkitë nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur këtij shërbimi kaq të rëndësishëm, duke mos e konsideruar zhvillimin e këtij shërbimi si një prioritet strategjik dhe duke mos e mbështetur atë në objektiva afatgjata të mirë përcaktuara.

Pavarësisht punës së përkushtuar të Drejtoreshës së QEZHEF, [REDAKTUAR] dhe stafit të saj, Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, si instrumenti i vetëm dhe më i lartë i planifikimit strategjik në nivel vendor, identifikon vetëm një objektiv strategjik sa i përket çerdheve dhe kopshteve dhe që lidhet me sigurimin e infrastrukturës. Ky objektiv përkthehet në një plan pune të ndarë në ndërtimin e 8 çerdheve dhe 7 kopshteve të reja nëpërmjet PPP, si dhe në ndërhyrjet e nevojshme infrastrukturore në 2 çerdhe dhe 11 kopshte ekzistuese²² deri në vitin 2020. Në këtë dokument nuk identifikohet asnjë prioritet tjetër strategjik që lidhet me të gjithë gamën e shërbimeve që ofrohet nga Bashkia apo QEZHEF, qoftë kjo në logjistikë,

²² Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022, Tabela nr. 30

shëndetësi, ushqim, etj. Krahas kësaj, nga grupi i auditimit evidentohet se nuk ka një kuadër ligjor e rregullator të posatshëm që orienton dhe përcakton ofrimin e të gjithë shërbimit në çerdhe dhe kopshte, që nga përcaktimi i organeve administruese, e në vazhdim me ato pjesëmarrëse në këtë proces, si dhe ato monitoruese. E njëjtë paraqitet situata edhe sa i përket Bashkisë Vlorë, e cila nuk ka asnjë prioritet apo objektiva strategjike për garantimin e një shërbimi sa më efektiv në kopshte dhe çerdhe. Mangësia kryesore që vihet re në këtë institucion, buron që nga forma e organizimit dhe rëndësia që i është kushtuar këtij shërbimi, pasi çerdhet dhe kopshtet në këtë qytet administrohen nga dy drejtori të cilat nuk kanë asnjë lidhje me këtë çështje, por që krahas detyrimeve dhe përgjegjësive prioritare që ato kanë, mbulojnë edhe shërbimin në kopshte dhe çerdhe. Administrimi i çerdheve dhe kopshteve në vendin tonë është ekstremisht heterogjen dhe në shumë raste vihet re një mungesë bashkëpunimi nga aktorët e përfshirë, kryesisht në dhënien e feedback nga ana e organeve monitoruese. Po kështu, vihet re se një pjesë e standardeve që aplikohen në fushën e menaxhimit të kopshteve dhe çerdheve janë shumë të hershëm dhe hartimi i tyre është mbështetur në një kuadër rregullator dhe struktura të cilat kanë ndryshuar ndër vite, e megjithatë këto dokumente ende nuk janë shfuqizuar. Nuk ka koherencë në dizenjimin e standardeve apo rregulloreve të nevojshme, pasi hartimi i tyre bëhet me iniciativa individuale të institucioneve të ndryshme sipas fushës së tyre të përgjegjësive duke shkaktuar mbivendosje, përsëritje apo edhe kontradikta në përmbajtjen e tyre. Sa i takon transparencës së detyrimeve dhe përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse për këtë shërbim, rezulton se kryesisht në Tiranë, gjatë vitit shkollor prindërit përballen me “kosto të fshehura” për pjesën më të madhe të nevojave që ka një shërbim i tillë si ujë, lodra, mjete didaktike, pajisje dhe orendi të tjera si lavatriçe, frigoriferë, soba ngrohje apo riparimi i tyre, arredime të ndryshme, etj. Në të dy rastet, Vendimet e Këshillit Bashkiak për tarifatat nuk shoqërohen me asnjë studim apo përlllogaritje të kostove apo elementëve të marra në konsideratë për arritjen në këtë tarifë përfundimtare, por specifikohet vetëm që kjo tarifë mbulon ushqimin gjatë qëndrimit në kopshte/çerdhe, me nënkuptimin se të gjitha nevojat e tjera do të garantohen nga Bashkia. Ky shqetësim është adresuar edhe në artikuj në media për periudhën nën auditim²³.

Sa i takon drejtimit të dytë, atë të garantimit të një shërbimi sa më optimal gjatë qëndrimit në kopshte dhe çerdhe, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim çështjen e ushqimit në këto institucione që nga pranimi i këtyre artikujve e deri në servirjen e tyre tek fëmijët, shërbimin shëndetësor dhe higjieno-sanitar të ofruar në këto institucione, si dhe garantimin e hapësirave dhe kapaciteteve fizike sipas standardeve në fuqi. Për sa më lart, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se, në rastin e QEZHEF procedura e verifikimit dhe marrjes në dorëzim të artikujve ushqimor nuk është parashikuar në mënyrën më eficiente të mundshme. Ajo kryhet e nxituar për të arritur shpërndarjen e këtyre artikujve çdo ditë brenda ditës në të gjithë kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, duke mbartur riskun e mos verifikimit të plotë dhe të detajuar të cilësisë dhe sasisë së artikujve. Për pasojë cilësia e këtij shërbimi cënohej nga pritja e gjatë e artikujve në kushte të papërshtatshme, mos verifikimi i detajuar i ambalazhimeve, apo peshimit të sasisë së plotë të marrë në dorëzim etj. Produktet ushqimore të menisë së ofruar, nuk janë plotësisht në përputhje me shijet e fëmijëve, shqetësim ky i evidentuar edhe në media²⁴. Mos konsumimi i disa prej artikujve ushqimor në raste të përsëritura, nuk është marrë në analizë nga QEZHEF së bashku me

²³ <https://www.reporter.al/parate-e-prinderve-mbajne-hapur-kopshtet-publike-te-tiranes/>

²⁴ <http://publik.live/menuja-per-femije-deshtimi-me-i-madh-i-blerina-bombaj/>

specialistë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për modifikime të nevojshme. Megjithëse kushtet higjieno-sanitare paraqiten pozitive, ka ende raste sporadike të cilat kanë nevojë për përmirësim, të tilla si zëvendësimi apo personalizimi i produkteve të higjienës personale, apo dhe nevoja për investime në ambiente dhe orendi. Shërbimi shëndetësor dhe ai psiko-social nuk janë aspak në nivelin e duhur dhe kanë nevojë për rikonceptim të mëtejshëm. Me përjashtim të çerdheve të Tiranës, ky shërbim është ende në nivele formale dhe nuk garanton rezultatet për të cilat funksionon. Ndërkohë që për Bashkinë Vlorë rezulton se nuk është garantuar shërbimi i duhur ushqimor dhe shëndetësor. Procesi i planifikimit dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore nga ana e QE është jo eficient dhe nuk garanton respektimin e menisë së miratuar. Në tërësi stafi përgjegjës për administrimin dhe ofrimin e shërbimit në kopshte dhe çerdhe nuk ka njohuri të mjaftueshme të akteve normative që orientojnë garantimin e këtij shërbimi, kryesisht rregullore apo standarde higjieno-sanitare apo të mirë ushqyerjes. Gjithashtu, u konstatua një shërbim mjekësor dhe psiko-social inegzistent si pasojë e mungesës së strukturave të posatshme përgjegjëse për administrimin e kopshteve dhe çerdheve pranë kësaj Bashkie, si dhe mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit mes Bashkisë, DAR rajonal dhe OShV Vlorë.

Aspekti tjetër i marrë në shqyrtim gjatë këtij auditimi lidhet me garantimin e ambienteve të përshtatshme dhe hapësirave fizike të nevojshme sipas standardeve të miratuara nga ku rezultoi se çështja e mbipopullimit të kopshteve dhe çerdheve është një problem shumë shqetësues i cili po trashëgohet vit pas viti dhe ende nuk po merret në shqyrtim me seriozitet për të dhënë një zgjidhje. Vitet e fundit është vënë re një angazhim i lartë nga institucionet vendore për përmirësimin e kushteve fizike që lidhen me godinat, pajisjet, orendi e mjetet didaktike, por sërish vërehet se infrastruktura fizike nuk i përgjigjet në të gjithë shtirjen e saj kërkesave bashkëkohore të standardeve. Përmirësime të dukshme hasen vetëm sa i takon rikonstrukcioneve të këtyre godinave në Tiranë, ndërkohë që gjenda e tyre në bashkinë Vlorë është e mjerueshme. Godinat në këtë qytet ndodhen në territore ku vështirësia për akses të fëmijëve është e pazakontë, ku megjithë vështirësitë e kushteve aspak të përshtatshme, si lagështi e theksuar, pellgje uji në hyrje, shkallë hekuri të improvizuara në anën e jashtme të ndërtesës, vendodhja e çerdhes në rrugicë dhe me trotuare që vështirëson kalimin e karrocave, fëmijët duhet të ndajnë ambientet e godinës pronë të Bashkisë me institucione të tjera jashtë fokusit të shërbimit parashkollor. Në të dyja qytetet, u vu re gjithashtu prania e portativëve për vaktin e gjumit, të cilat përbëjnë një shqetësim madhor për shëndetin fizik të fëmijës. Theksojmë në këtë rast se fjetja në kushte të pa përshtatshme dhe dëmet në formimin fizik gjatë kësaj moshe janë të patiparueshme. Po kështu, në të dy rastet u konstatua se si pasojë e mungesës së hapësirave të nevojshme, i njëjti ambient shërbente edhe për aktivitetet ditore dhe në përfundim të tyre ngriheshin tavolinat dhe shtroheshin portativët për fjetjen. Së fundmi, u konstatua masivisht mungesa e dhomave të veçanta të mjekut, psikologut dhe të izolimit në rast sëmundje të fëmijës, si dhe elementët e sigurisë për mbrojtjen nga emergjencat, apo kamerat në ambientet e godinave, në kundërshtim me standardet e projektimit.

4. Aneks²⁵

Të dhënat për çerdhet 2017-2018 Tiranë

²⁵ Burimi: QEZHEF dhe Bashkia Vlorë

	Te regjistruar	Frekuentim mesatar mujor	Numri i edukatoreve		Të regjistruar	Frekuentim mesatar mujor	Numri i edukatoreve	
Çerdhet	Dhjetor 2017	Dhjetor 2017	Dhjetor 2017	Raporti edukator /femije	Dhjetor 2018	Dhjetor 2018	Dhjetor 2018	Raporti edukator /femije
1	147	110	18	8	146	110	20	7
4	196	129	16	12	140	86	18	8
8	195	130	20	10	153	103	18	9
10	95	84	12	8	131	77	14	9
11	75	46	9	8	85	50	9	9
13	87	65	9	10	89	56	10	9
14	103	66	9	11	103	63	12	9
15	84	49	8	11	91	50	9	10
16	156	87	13	12	170	82	15	11
17	149	93	14	11	178	96	18	10
19	90	45	7	13	73	46	11	7
23	134	89	16	8	123	81	13	9
24	107	83	14	8	144	85	15	10
26	106	65	9	12	90	51	11	8
30	130	90	14	9	147	99	17	9
35	136	83	13	10	150	104	16	9
42	72	50	9	8	79	51	10	8
45	143	87	15	10	129	82	16	8
47	134	78	14	10	139	76	13	11
48	130	94	13	10	140	85	16	9
50	94	65	9	10	98	61	10	10
51	102	59	10	10	104	68	13	8
52	174	105	18	10	179	116	20	9
54	117	78	12	10	110	60	13	8
56	111	77	12	9	112	62	11	10
57	141	77	13	11	150	80	14	11
C 58 Bregu i Lumit	42	28	5	8	54	31	6	9
C 59 K. Kamëz	53	35	7	8	56	41	7	8
Shkozë	52	42	5	10	55	37	6	9
Xixëllonja 61	119	78	13	9	133	89	14	10
Çerdhja 62	63	41	7	9	73	53	8	9
Çerdhja 33	75	55	9	8	97	57	11	9
Çerdhja 21					62	42	6	10
Çerdhja 34					94	42	8	12

Të dhënat për kopshtet 2017-2018 Tiranë

	Të regjistruar	Frekuentim mesatar mujor	Numri i edukatoreve	Raporti edukator/femije	Të regjistruar	Frekuentim mesatar mujor	Numri i edukatoreve	Raporti edukator/femije
Kopshtet	Dhjetor 2017	Dhjetor 2017	Dhjetor 2017		Dhjetor 2018	Dhjetor 2018	Dhjetor 2018	
1	148	91	8	19	167	94	8	21
2	188	120	8	24	173	98	8	22
3	240	128	7	34	215	102	7	31
6	233	133	8	29	229	132	8	29
8	223	133	10	22	232	124	10	23
11	161	140	7	23	159	97	7	23
14	254	130	12	21	258	156	12	22
17	143	115	7	20	171	102	7	24
18	209	86	8	26	221	140	10	22
19	171	104	7	24	178	114	8	22
20	178	102	8	22	191	123	8	24
21	140	88	7	20	140	89	7	20
22	165	120	7	24	151	87	7	22
24	229	135	8	29	227	133	8	28
25 A	130	73	7	19	125	69	7	18
25 TR	216	137	7	31	186	94	7	27
26	208	119	7	30	221	120	7	32
27 A	184	82	9	20	162	82	9	18
27 K	121	65	7	17	130	72	7	19
28	129	61	4	32	116	51	4	29
29	143	84	7	20	148	88	7	21
31	231	147	15	15	245	136	14	18
34					60	36	4	15
34/k	62	29	4	16	70	30	4	18
35	153	103	8	19	146	93	8	18
36	196	169	7	28	203	124	7	29
38 K	146	110	8	18	145	74	7	21
39	125	72	7	18	161	88	7	23
40	175	107	8	22	168	105	8	21
41	248	125	8	31	283	155	9	31
42	189	108	8	24	172	107	8	22
43	149	86	7	21	159	89	7	23
45	284	165	15	19	266	146	15	18
51	157	103	8	20	157	96	7	22
52	117	74	7	17	129	79	8	16
56	191	104	8	24	163	106	8	20

64 (Xixëllonjat)	120	75	6	20	174	105	6	29
Kopshte pa drekë								
Kopshti Shkozë e Vjetër	107	90	2	54	80	80	2	40
Kopshti Shkozë e Re	100	80	2	50	95	77	2	48
Kopshti Sauk	182	140	5	36	150	95	6	25
Kopshti 60	63	33	3	21	60	57	2	30
Kopshti 55	155	120	4	39	161	98	4	40
Kopshti Selitë	25	18	1	25	20	18	1	20
Kopshti Kodër Kamëz	108	85	4	27	115	90	4	29
Kopshti Bregu i Lumit	200	63	4	50	198	164	4	50

Të dhënat për kopshtet dhe çerdhet Vlorë 2017-2018

Kopshti	Te regjistruar	Edukatore	Raporti edukator/femije	Çerdhet	Te regjistruar	Edukatore	Raporti edukator/femije
Kopshti nr.1	114	7	16	2	30	4	8
Kopshti nr.2	152	22	7	15	29	5	6
Kopshti nr.3	110	8	14	4	30	4	8
Kopshti nr.5	93	5	19				
Kopshti nr.7	142	7	20				
Kopshti nr.8	102	9	11				
Kopshti nr.9	181	19	10				
Kopshti nr.10	243	16	15				
Kopshti nr.11	176	15	12				
Kopshti nr.13	125	11	11				
Kopshti nr.14	170	8	21				
Kopshti nr.15	110	7	16				
1 maj	144	11	13				
Lef sallata	103	7	15				
Musa çakërrri	70	3	23				
4 heronjtë	54	3	18				
Zigur lëlo	56	3	19				
Zenel murra	48	2	24				
Zenel murra - 7 pallatet	42	2	21				
Zonje curre	14	1	14				
Xhevdet lagji	17	1	17				
Hasan mehilli	49	3	16				
Dukat fshat	10	1	10				

Mustafa q. Ataturk	106	5	21			
Perlat rexhepi-cerkovinë	20	1	20			
Skrofotine	15	1	15			
Reshat-hoxha-akërni	12	1	12			
Pilo prifti	48	2	24			
Mifol	17	1	17			
Avni rustemi-trevëllazër	32	2	16			
Loni mone-poro	14	1	14			
Delisuf	12	1	12			
Dellenje	13	1	13			
Ismail qemalli-fitore	29	2	15			
Kafil malaj	38	2	19			
Faslli danaj	66	3	22			
Mekat	13	1	13			
Grabian	20	1	20			
Idris rustemi	46	3	15			
Rrapo hesimi	23	1	23			
Lili gori	33	2	17			
Taulla xhafa	15	1	15			
Xhemil bregu	22	1	22			
Hajredin haxhiraj-kerkovë	17	1	17			
Ilia kicidashi - bestrove	10	1	10			
Festim hoxha	15	1	15			
Babicë e vogël	16	1	16			
Selam musai	105	5	21			
Nikolla xhuvëli-nartë	28	2	14			
Stavri bombaj	69	4	17			
Mynyr xhindi	34	2	17			
Belo belaj	16	1	16			
Deshmoret e peshkepise	23	1	23			
Qazim sina	18	1	18			
Sile hoxhaj	15	1	15			
Razip sadikaj	13	1	13			
Picar	15	1	15			
Filo ramadani	30	2	15			
Ramiz sadikaj	15	1	15			
Hamdi rrapo-gjorm	23	2	12			
Laze nuro	15	1	15			
Sadik zotaj	10	1	10			
Sefer shanaj	10	1	10			
Qeriba derri	10	1	10			
Haki bylyshi	30	2	15			
Eqerem beqiri	52	3	17			
Perlat rexhepi-vajzë	15	1	15			
Ismail azizi	12	1	12			
Qani nuredini	18	1	18			
Shkoze	18	1	18			
Himare	59	2	30			
Qeparo	15	1	15			
Gjik bixhili	24	1	24			
Memo mete	11	1	11			

Kuç - buronja	11	1	11				
Hore - vranisht	11	1	11				
Vranishte - fshat	11	1	11				
Bolene	11	1	11				

5. Grupi i punës dhe përgjegjësitë hierarkike

Redina Karapici, Përgjegjëse e grupit të auditimit;
Eva Kasmir, Anëtare e grupit të auditimit;
Eva Kushta, Anëtare e grupit të auditimit.

Drejtor i Departamentit

Rinald MUÇA